



Bashkimi Evropian

Një përmbledhje e shkurtër

Jehona Lushaku Sadriu

Botimi II

BASHKIMI EVROPIAN

Një përmbledhje e shkurtër

Jehona Lushaku Sadriu

Botimi II

Prishtinë, 2020

Diellit dhe Adës,
fëmijëve të Kosovës,
për të ardhmen e tyre
evropiane.

Impresum

Titulli:

Bashkimi Evropian, Një përmbledhje e shkurtër

Botues:

Fondacioni-Konrad-Adenauer në Republikën e Kosovës

Autor:

Jehona Lushaku Sadriu

Koordinimi:

Granit Tërnavë

Shtypi dhe dizajni:

Artgraphic

Tirazhi:

1000 ekzemblarë

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

<http://www./kas.de/Kosovo>

Vërejtje:

Qëndrimet e prezantuara në këtë libër janë pikëpamje personale të autorit dhe ato nuk paraqesin patjetër qëndrimet e Fondacionit-Konrad-Adenauer.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovë “Pjetër Bogdani”

Lushaku Sadriu, Jehona

Hyrje në Bashkimin Evropian / Jehona Lushaku Sadriu - Prishtinë:
Fondacioni-Konrad-Adenauer, 2020. – 125 f. 25 cm, Hyrje: f 11-12, -
Shënime dhe referenca: f. 120-122

ISBN 978-9951-8664-1-5

Përmbajtja:

Hyrja.....	11
Recension.....	13
1.Historia e Bashkimit Evropian.....	16
1.1 Idetë e para të formimit të Bashkimit Evropian.....	16
1.2 Formimi i Bashkimit Evropian.....	19
2.Arkitektura institucionale e Bashkimit Evropian.....	28
2.1 Këshilli Evropian.....	29
Përbërja dhe kompetencat.....	30
2.2 Këshilli i (ministrave) të BE-së.....	31
2.3 Parlamenti evropian.....	37
Përbërja dhe mënyra zgjedhjes së deputetëve të Parlamentit Evropian.....	41
2.4 Komisioni evropian.....	44
Përbërja dhe procedura e emërimit të anëtarëve të Komisionit Evropian.....	46
Struktura organizative e Komisionit Evropian.....	50
Organizimi i punës së Komisionit evropian.....	50
Propozimi i legjislacionit të ri.....	52
Implementimi i politikave të BE-së dhe buxheti.....	52
Zbatimi i ligjit evropian.....	53
Përfaqësimi i BE-së në arenën ndërkombëtare.....	53
2.5 Banka Qendrore Evropiane.....	54
2.6 Banka Evropiane e Investimeve.....	57
2.7 Gjykata evropiane e drejtësisë.....	59

2.8 Gjykata evropiane e auditorëve.....	63
2.9 Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social.....	65
2.10 Komiteti i Rajoneve.....	67
3. Vendimmarrja në Bashkimin Evropian.....	70
3.1 Procedura e bashkëvendim-marrjes (e zakonshme legislative).....	71
3.2 Procedura e konsultimit.....	72
3.3 Procedura e pëlqimit.....	72
4. Rendi ligjor i BE-së.....	76
4.1 Burimet primare.....	76
4.2 Burimet sekondare të BE-së.....	77
4.3 Marrëveshjet ndërkombëtare të BE-së.....	79
5. Procesi i zgjerimit të Bashkimit Evropian.....	82
5.1 Negociatat e anëtarësimit.....	84
5.2 Vlerësimi.....	85
5.3 Raportimi dhe mbikqyrja.....	87
5.4 Traktati i anëtarësimit.....	87
5.5 Ndhimja për vendet për anëtarësim.....	87
5.6 Mbështetja e BE-së në procesin e anëtarësimit.....	89
6. Ballkani dhe Bashkimi Evropian.....	91
7. Kosova dhe Bashkimi Evropian.....	98
8. Procesi i des-integrimit të BE-së.....	106
8.1 BREXIT.....	106

Shtojca 1. Themeluesit e Bashkimit Evropian.....	108
Shtojca 2: Përfaqësimi i BE-së në Kosovë.....	111
Shtojca 3: Fjalorth.....	114
Literatura dhe burimet.....	120

Lexues të nderuar,

Integrimi Evropian i Kosovës mbetet një prej prioriteteve kryesore të vendit. Përfshirja në familjen e vlerave të përbashkëta është një sfidë e cila duhet të pranohet nga të gjithë ne. Në dhjetë vitet e funksionimit tonë në Kosovë, Fondacioni-Konrad-Adenauer e ka trajtuar këtë temë me seriozitet dhe përkushtim me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të vendit për Integrim Evropian. Libri që keni para vetes, i shkruar nga Jehona Lushaku-Sadriu, ligjëruese pranë Departamentit të Shkencës Politike synon të ju sjell më afër jush idenë e Bashkimit Evropian, si një hyrje në një mundësi të gjerë studimi e veprimi. Fondacioni ynë mban me krenari emrin e Konrad Adenauer-it, kancelarit të parë të pas luftës së dytë botërore që ishte ndër themeltarët e Unionit Evropian, prandaj përkrahja e këtij libri ka një rëndësi të veçantë për ne.

Të dashur nxënës të shkollave të mesme të Kosovës, ky libër duhet të ju shërbej juve që të njoftoheni më shumë me Bashkimin Evropian dhe atë që ai përfaqëson.

Përmes kapitujve të ndryshëm, në libër janë trajtuar temat të ndryshme me qëllim të prezantimit të sa më shumë informacioneve të rëndësishme në lidhje me Bashkimin Evropian.

Zonja Lushaku-Sadriu është një pishtare e Integritimit Evropian të Kosovës dhe pjesë e familjes sonë të KAS Alumni, një rrjeti të madh bursistësh nga mbarë bota, të cilën angazhohen për promovimin e vlerave tona të përbashkëta. Shpresojmë që shumë prej jush do të keni rastin e mundësinë të na bashkoheni në këtë familje në faza të mëtejme të zhvillimit tuaj akademik.

Ju dëshirojmë lexim të këndshëm.

Fondacioni-Konrad-Adenauer, Zyra në Kosovë

HYRJE

Hyrje

Ky libër përmbledhë temat kryesore që lidhen me të kuptuarit e Bashkimit Evropian duke u fokusuar në: historinë e zhvillimit të Bashkimit Evropian, institucionet kryesore vendim-marrëse, mënyrën e funksionimit, zgjerimin dhe raportet me Ballkanin e Kosovën. Libri ju kushtohet nxënësve të arsimit të mesëm dhe trajton tema që shumë sipërfaqësisht janë të përfshira në kurrikulën shkollore.

Ky libër fillimisht pasqyron historinë e formimit të Bashkimit Evropian, që nga idetë e para për formimin e BE-së, nënshkrimin e traktateve formuese, momentet historike që kanë thelluar integrimin, si dhe sfidat e ndryshme nëpër të cilat kanë kaluar shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Krahas historikut të BE-së, në kapitujt vijues trajtohet arkitektura institucionale e Bashkimit Evropian në bazë të traktatit të Lisbonës, i cili është në fuqi. Institucionet më të rëndësishme vendimmarrëse do të trajtohen ndaras duke përshkruar mënyrën e zgjedhjes, përbërjen, rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit institucion. Në këta kapituj përfshihen edhe mënyrat e vendimmarrjes si dhe ndërvarshmëria institucionale në rrugën e nxjerrjes së vendimeve brenda BE-së.

Përfundimisht, ky libër trajton edhe politikën e zgjerimit të Bashkimit Evropian, duke u fokusuar në raportin e Bashkimit Evropian me Ballkanin Perëndimor, përkatësisht Kosovën.

Duke marrë parasysh lexuesit të cilëve u drejtohet ky libër, unë kam thjeshtëzuar përshkrimin dhe reduktuar numrin e citimeve. Ky libër mbështetet në të dhënat zyrtare të institucioneve të BE-së dhe institucioneve të Kosovës dhe literaturën e bashkangjitur.

Libri u përkrah nga Fondacioni-Konrad-Adenauer, Zyra në Kosovë.

Recension

Të diskutosh për Bashkimin Evropian dhe të e kuptosh atë në tërësinë e saj, nuk është aspak e thjeshtë e as e lehtë. Prandaj doracaku nga Jehona Lushaku Sadriu, me gjuhën e kuptueshme dhe në mënyrë të strukturuar, arrin që të përmbledh me mjeshtri historikun e zhvillimit, arkitekturën institucionale, procedurat politkëbërëse dhe vendimmarrëse, sikurse edhe të sqaroj procesin e zgjerimit dhe kushtet e anëtarësimit në të. Është jashtëzakonisht e rëndësishme për Kosovën, si shtet i ri dhe me aspirata për anëtarësim në Bashkimin Evropian, që të i përmbush kriteret dhe të arrij standardet e përcaktuara të cilat do të ia mundësojnë të bëhet pjesë e familjes evropiane. Mirëpo, parakusht i kësaj është që fillimisht shoqëria, e veçanërisht rinia e Kosovës, të i kuptojnë drejt e mirë, dhe të angazhohen që ky synim të realizohet sa më parë.

Temat e trajtuara jo vetëm që mundësojnë njoftimin me Bashkimin Evropian, por hapin edhe horizonte të reja të krijimit të vlerave që do të e për afrojnë Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së. Autorja me angazhimet e saja profesionale dhe me këtë doracak arrin që të jap kontributin e çmueshëm, tani ju mbetet edhe lexuesve si Evropianë të Rinj, që të kontribuojnë tutje në këtë drejtim.

Prof. Asoc. Dr. Bekim Baliqi,
Departamenti i Shkencës Politike, Universiteti i Prishtinës.



1. Historia e Bashkimit Evropian

Në pjesën e parë të shekullit XIX, kontinenti Evropian ishte arenë e konflikteve dhe luftërave, që shkaktuan miliona njerëz të vdekur dhe dëme të shumta materiale. Vetëm gjatë periudhës 1870 deri në vitin 1945 Franca dhe Gjermania tri herë kanë qenë në luftë njëra me tjetrën. Liderët Evropianë erdhën në përfundim se vetëm integrimi ekonomik dhe ai politik mund të sigurojë paqe mes shteteve.

1.1 Idetë e para të formimit të Bashkimit Evropian


Nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, Evropa doli e shkatërruar dhe me shumë viktima në njerëz. Në kushte shumë të vështira, me ndihmën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shtetet e Evropës Perëndimore filluan rindërtimin dhe ri-konsolidimin e shteteve. Liderët, krahas konsolidimit të shteteve, filluan të mendojnë për opsione që do të parandalonin luftëra të reja.

Ndërkohë, që Lufta e ftohtë filloi të ashtpërsohej, Evropa mbeti si pikëtakim i rivalitetit të SHBA-së dhe BRSS-së. Për t'u mbrojtur nga rreziku që Lufta e Ftohtë mund t'i shkaktonte Evropës, liderët e shteteve të Evropës Perëndimore panë të domosdoshme të kujdeseshin se bashku për çështjen e sigurisë.

Me këtë qëllim u organizua Kongresi i Evropës i mbajtur në Hagë në Maj 1948 i cili u ndoq prej delegatëve të 16 shteteve evropiane dhe vëzhguesve nga Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja. Në këtë kongres u diskutuan shumë çështje ambicioze për Evropën, por u arrit pëlqimi për formimin e Këshillit të Evropës.

Këshilli i Evropës arriti të zyrtarizohej më 1949 në Londër me ç'rast u nënshkrua statuti i tij prej 10 shtetesh evropiane. Këshilli i Evropës, si organizatë ndërqeveritare arriti të shënojë përmirësime në të drejtat e njeriut, çështjeve kulturore dhe në një nivel të kufizuar në bashkëpunimin ekonomik.

Ministri i jashtëm francez Robert Schuman dhe diplomati dhe këshilltari politik francez Jean Monnet synonin diçka më thelbësore në lidhje me bashkëpunimin ekonomik në mes të shteteve si Franca e Gjermania.



1. Jean Monnet, Robert Schuman dhe Konrad Adenauer- themeluesit e Bashkimit Evropian, 1950

Formimi i idesë për një bashkëpunim fillestar, domethënës dhe jo shumë ambicioz u fokusua tek industrinë e qymyrit dhe çelikut, të cilat ofronin një potencial të madh për një bashkëpunim evropian. Jean Monnet, e mbështeti këtë ide në disa argumente:

- Qymyri dhe çeliku ishin bazat mbi të cilat ngrihej industria. Bashkëpunimi do të eliminonte shpërdorimet, do ta bënte më cilësor dhe konkurrues prodhimin e qymyrit e çelikut, si dhe do të stimulonte zhvillimin industrial.
- Gjermania dhe Franca kishin rezerva të qymyrit në Alsace-Lorraine dhe industri të rënda në krahinën e Ruhrit që kishin shërbyer si lëndë e parë e industrisë dhe prodhimit të armëve. Andaj, mënyra më e mirë për të kontrolluar zhvillimin e industrive të rënda dhe të armëve do të ishte në një organizatë ndër-qeveritare, që do të mbikqyrte këtë prodhim.

Jean Monnet, së bashku me Robert Schuman dhe kancelarin gjerman Konrad Adenauer u dakorduan të propozonin krijimin e një autoriteti të pavarur prej qeverive kombëtare me karakter ndër-qeveritar.

Robert Schuman, më 9 Maj 1950 prezantoi idenë e krijimit të një organizate të përbashkët evropiane. Ky prezantim u quajt më vonë ,Deklarata e Schuman-it'. Në të elaborohej propozimi që prodhimi francez dhe gjerman i qymyrit dhe çelikut të vendosej nën një Autoritet të Lartë të përbashkët, në kuadër të një organizate ku mund të bënin pjesë edhe vende të tjera evropiane. Në bazë të kësaj deklarate, Evropa nuk do të bashkohej/integrohej menjëherë, por hap pas hapi në një proces integrues në bazë të arritjeve konkrete. Kjo do të mënjanonte konfliktin dhe armiqësinë në mes të Francës dhe Gjermanisë dhe do të ishte hapi i parë drejt një Evrope federale.



2.Prezantimi i Deklarates së Schuman-it, 9 Maj 1950

Deklarata e Shumanit është propozim historik, për arsye se Franca po ofronte të sakrifikoje pjesë të sovranitetit të vet kombëtar për hir të ndërtimit të paqes.

Qeveritë e gjashtë vendeve: Franca, Gjermania Perëndimore, Italia, Holanda, Belgjika, dhe Luksemburgu, nisën negociatat dhe në 18 Prill 1951 nënshkruan Traktatin e Parisit, duke krijuar në këtë mënyrë Komunitetin Evropian të Qymyrit dhe Çelikut.

1.2 Formimi i Bashkimit Evropian

Formimi i Bashkimit Evropian është rezultat i politikanëve evropianë të cilët donin të parandalonin konflikte të reja në Evropë përmes bashkëpunimit ndërshtetëror.

Qëllimi kryesor për formimin e BE-së ka qenë bashkëpunimi i ngushtë në mes të shteteve në fushën e industrisë dhe ekonomisë. Para së gjithash, parashihej që BE të kontrollonte prodhimin e qymyrit dhe çelikut, si lëndë e parë për prodhimin e armëve.

Propozimi i Ministrisë të Punëve të Jashtme të Francës, Robert Schuman në vitin 1950 përfshinte integrimin e industrive evropiane të qymyrit dhe çelikut në nënshkrimin e **Traktatit të Parisit** në vitin 1951, duke krijuar Komunitetin Evropian të Qymyrit dhe Çelikut (ECSC).



3.Nënshkrimi/ratifikimi i Traktatit të Parisit në prill 1951 (Franca, Gjermania, Italia, Holanda, Luksemburgu dhe Belgjika)

Në atë periudhë të pasluftës Komuniteti është parë kryesisht si një mënyrë e mirë për sigurimin e paqes, e cila do të lejonte që shtetet të bashkëpunonin si të barabarta.

Me Traktatin e Parisit u themeluan katër institucione evropiane:

- > Autoriteti i lartë: krahu ekzekutiv ndaj shteteve anëtare dhe kompanitë e tyre, me nëntë anëtarë
- > Këshilli: organi legjislativ (i kufizuar)
- > Asambleja Parlamentare: E përbërë nga delegatë nga parlamentet e shteteve anëtare
- > Gjykata e Drejtësisë

Të njëjtat shtete në vitin 1957 nënshkruan Traktatin e Romës duke krijuar Komunitetin Ekonomik Evropian dhe Komunitetin Evropian për energji atomike – EURATOM. Qëllimi kryesor i këtyre marrëveshjeve ishte thyerja e barrierave tregtare mes tyre drejt krijimit të një tregu të përbashkët me lëvizje të lirë të fuqisë punëtore, mallrave dhe shërbimeve. Me këto traktate u hoqën detyrimet doganore në prodhimin të produkteve të vendeve anëtare dhe u themeluan politika të përbashkëta bujqësore dhe tregti të jashtme.

Në vitin 1967 hyri në fuqi Traktati i Bashkimit me të cilin u bë një integrim institucional i Komuniteteve: Komuniteti Ekonomik Evropian (EEC), Komuniteti Evropian i Qymyrit dhe Çelikut (ECSC) dhe EURATOM u shkrinë në këto institucione: Komisionin evropian, Këshillin evropian dhe Parlamentin evropian.

Suksesi i gjashtë shteteve themeluese i shtyu edhe shtetet tjera që të aplikojnë për t'u bërë anëtare të Komunitetit Evropian. Në vitin 1973 u bë zgjerimi i parë i Komunitetit Evropian me anëtarësimin e Danimarkës, Irlandës dhe Mbretërisë së Bashkuar. Ato u anëtarësuan në këtë Komunitet pas negociatave të vështira dhe shumë të gjata. Franca në krye me presidentin Charles De Gaulle dy herë ka përdorur veton kundër anëtarësimit të Mbretërisë së Bashkuar, në vitin 1961 dhe vetoja e dytë në vitin 1967. Pas përfundimit të negociatave Danimarka, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar aplikuan përfundimisht në vitin 1972 dhe u bënë anëtare të reja të Komunitetit Evropian në vitin 1973. Ky zgjerim i parë i cili rriti numrin e shteteve anëtare nga gjashtë në nëntë, ishte lidhur ngushtë edhe me rritjen e përgjegjësisë në çështjet sociale, rajonale dhe mjedisore.

Ngjarja më e veçantë në kuptimin e legjitimitetit direkt ka ndodhur në vitin 1979, me zgjedhjet e para direkte për Parlamentin Evropian nga elektorati i secilit shtet anëtar. Parlamenti evropian është institucioni me i rëndësishëm legjislativ mbikombëtar.

Në fillim të viteve të 70-ta, kur Shtetet e Bashkuara pezulluan këmbyeshmërinë e dollarit u paraqit nevoja për një bashkim monetar evropian. Kjo shënoi fillimin e një periudhe të paqëndrueshmërisë monetare në tërë botën, rënduar nga dy krizat e naftës së vitit 1973 dhe 1979. Shtetet anëtare themeluan **Sistemit Monetar Evropian** në vitin 1979, i cili ndihmoi në stabilizimin e normave të këmbimit dhe inkurajoi shtetet anëtare të ndjekin politika të rrepta ekonomike.

Kurse në vitin 1981 Greqia i bashkohet Komunitetit Evropian, duke u zgjeruar edhe me Spanjën dhe Portugalinë në vitin 1986, pasi këto vende shpëtuan nga diktaturat e tyre dhe iu bashkuan familjes së madhe evropiane. Vitet 1970-1980 shënuan një kthesë për Komisionin Evropian. Komuniteti evropian filloi të luante një rol të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare, me nënshkrimin e marrëveshjeve të reja në vendet e Mesdheut jugor, gjithashtu me Afrikën, Karaibe e Paqësor. Në vitin 1986 Portugalia dhe Spanja i bashkohen Komunitetit evropian.

Komuniteti evropian arriti të bëhej si partneri më i madh tregtar në botë. Në këtë rol, Komuniteti kishte bërë përpjekje që të nxiste një bashkëpunim për Politiken e Jashtme dhe të Sigurisë në nivel më të lartë të përfaqësimit me të cilën do të identifikohesh në arenën ndërkombëtare. Por, kjo mbetet një ambicie në nivel bashkëpunimi ndërqeveritar, për shkak se shtetet anëtare dëshirojnë të mos e dorëzojnë këtë fushë në nivelin e BE-së

Në vitin 1986 është nënshkruar **Akti i Vetëm Evropian** nga qeveritë e shteteve anëtare, duke siguruar një treg të vetëm në të cilën njerëzit, mallrat, kapitali, mund të lëvizin lirshëm në BE. Akti i vetëm evropian i futi shtetet anëtare në një dimension tjetër me një program ambicioz për krijimin e një Bashkimit Monetar në vitin 1999, politika të reja të përbashkëta, shtetësi evropiane (European Citizenship), një politikë të jashtme të përbashkët dhe të politikave të sigurisë si dhe sigurinë e brendshme. Ky traktat parashihte poashtu procedura të reja lidhur me miratimin e legjislacionit, pra heqjen e vetos së shteteve anëtare në çështjet e brendshme politike të tregut dhe futja e 'shumicës së cilësuar' si mënyrë e vendimmarrjes.

Implementimi i këtij traktati ishte i vështirë për shkak të implikimeve ekonomike që kishte për shtetet anëtare. Këto vështirësi, e posaqërisht grindjet e brendshme për shpërndarjen e financave shpjen tek një fazë e europesimizmit. Ky fakt krijoi një nevojë për përpjekje shtesë të liderëve të shteteve anëtare për gjetjen e një perspektive të re për Komunitetin. Me këtë rast Komisioni i kryesuar nga Jacques Delors harton “Librin e Bardhë” dhe Komuniteti i vuri vetes detyrë krijimit të një të tregu të vetëm nga 1 janari 1993.

Në vitin 1992 u nënshkrua **Traktati i Mاستrihtit**, një ndër traktatet më të rëndësishme që ndërroi emrin nga Komunitet në Bashkim Evropian. Ky traktat e strukturoi/integroji Bashkimin në tri shtylla: komuniteti ekonomik; politika e jashtme dhe e sigurisë; drejtësia dhe punët e brendshme. Ky traktat parashikoi një formë të re të bashkëpunimit në mes të qeverive të shteteve anëtare si psh, në fushën e mbrojtjes, drejtësisë dhe çështjeve të brendshme.

Bashkimi Evropian në tri shtylla

Komuniteti Evropian: Unioni doganor

Tregu brendshëm

Demokratizimi i
institucioneve

Qytetaria evropiane

Unioni ekonomik dhe
monetar

Politika e Jashtme dhe e Sigurisë:


Politika e përbashkët
e jashtme

(Eventualisht)
Politika e Sigurisë

Drejtësia dhe Punët e brendshme:

Politikat ndërkufitare,
të azilit, migrimit,
bashkëpunimi juridik,
luftimi i drogës,
krimit, etj.

Liderët e Bashkimit Evropian gjithashtu u dakorduan që të krijojnë Bashkimin Ekonomik dhe Monetar, me një monedhë të përbashkët të menaxhuar nga Banka Qendrore Evropiane. Tregu i Përbashkët formalisht u kompletua, por mbetj edhe shumë punë për t'u përfunduar dhe për të përmbushur premtimin për lëvizje të lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve si dhe kapitalit.



5. Traktati i Maastricht-it

Traktati i Maastricht-it (1991), rënia e murit të Berlinit që u ndoq me bashkimin e të dy Gjermanive me 3 Tetor 1990, liberalizimi nga kontrolli Sovjetik dhe vështirësitë e demokratizimit të shteteve në Evropën Qendrore dhe Lindore si dhe ndarja e Bashkimit Sovietik në Dhjetor 1991, transformuan strukturën politike në Bashkimin Evropian.

Më 1 janar 1995 ndodhi zgjerimi i katërt i BE-së, me ç'rast tri vende të tjera u bashkuan Bashkimit Evropian: Austria, Finlanda dhe Suedia. Më tej, Bashkimi i të pesëmbëdhjetë shteteve u përball me dy sfida të mëdha: 1. Suksesin për t'u zgjeruar edhe më tutje duke përfshirë dhjetë shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore si dhe të Maltës dhe 2. Përdorimi i dinamikës së bashkimit monetar, e cila bazuar në krijimin e euros në 2 maj 1998, duhej të ofronte ekonomitë e shteteve anëtare me kushte për rritje të përhershme të krijimit të vendeve të reja të punës.

Bashkimi Evropian me traktatet vijuese u fokusua në forcimin e funksionimit të Bashkimit dhe rritjes së efikasitetit. Traktati i Amsterdimit hyri në fuqi në Maj 1999, në të cilin traktat, shtetet anëtare u dakorduan për një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me përshtatjen dhe forcimin e politikave të BE-së, veçanërisht në bashkëpunimin gjyqësor, lëvizjen e lirë të personave, politikën e jashtme etj. Parlamentit Evropian me këtë traktat iu dhanë kompetenca shtesë, duke konfirmuar rolin e tij ligjvënës.

Në vitin 1999, Valuta e vetme evropiane - EURO € kishte nisur të zbatohet zyrtarisht në njëmbëdhjetë shtete anëtare të Bashkimit Evropian të cilat e pranuan atë si valutë kombëtare, duke formuar kështu EUROZONËN.



6. Monedha EURO

Me **Traktatin e Nicës** që hyri në fuqi në shkurt të vitit 2003 është arritur përshtatja institucionale për zgjerim të mëtutjeshëm me dhjetë vende të reja anëtare. Një nga rezultatet e Traktatit të Nicës ishte miratimi unanim i Kartës Evropiane për të Drejtat Themelore, një dokument me më shumë se 50 nene që përmbajnë përpilimin e lirive personale, të drejtat ekonomike dhe sociale në traditën e përgjithshme të së drejtës evropiane. Kurse në vitin 2001 Traktati i Nicës u nënshkrua, duke i hapur rrugë zgjerimit të mëtejshëm të Bashkimit Evropian, ndërkohë që edhe Greqia iu bashkua EUROZONËS.

EURO-ja u bë realitet më 1 Janar 2002, ku bankënotat Euro dhe paratë metalike euro zëvendësuan paratë vendore në 12 nga 15 shtete anëtare të Bashkimit Evropian: Austria, Belgjika, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Portugalia dhe Spanja.

Dhjetë vende të reja ju bashkuan Bashkimit Evropian në vitin 2004: duke përfshirë tetë shtete nga Evropa Qendrore dhe Lindore. Shtetet që ju bashkuan Bashkimit Evropian në vitin 2004 ishin: Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia.

Udhëheqësit e BE-së arritën marrëveshje për **Traktatin Kushtetues**, i cili përmblihte të gjitha traktatet e mëparshme të BE-së së bashku në një dokument që rezultonte në ndryshime në mënyrën se si Bashkimi Evropian funksionon. Udhëheqësit e BE-së argumentuan këto ndryshime si të nevojshme për të siguruar se Bashkimi Evropian mund të vazhdojë të veprojë në mënyrë efektive edhe pas zgjerimit. Shtetet anëtare kishin kohë dy vjet për të ratifikuar Traktatin Kushtetues në shtetet e tyre. Ashtu si të gjitha traktatet e BE-së, ky Traktat mund të hynte në fuqi vetëm nëse miratohej nga të gjitha vendet anëtare. Referendumet për Traktatin Kushtetues në vitin 2004 janë mbajtur në katër shtete: Luksemburgu dhe Spanja votuan në favor, por Franca dhe Holanda votuan kundër Traktatit. Arësyeja e mos miratimit kishte të bënte kryesisht me frikën që shkaktonte emërtimi 'kushtetues' për këtë Traktat, si akti më i lartë juridik evropian e që i dorëzonte më shumë kompetenca institucioneve mbikombëtare nga niveli i shteteve anëtare.

Në Qershor 2006, 15 nga gjithsej 25 Shtete anëtare e ratifikuan Traktatin. Këshilli Evropian u bëri thirrje udhëheqësve të BE që të miratojnë një deklaratë politike që përcaktonte vlerat dhe ambiciet e Bashkimit Evropian duke konfirmuar angazhimin e tyre të përbashkët. Gjermania, e cila mbante Kryesimin e Bashkimit në gjysmën e parë të vitit 2007, prezantoi një raport në

Këshillin Evropian lidhur me vështirësitë e shteteve për miratimin e Traktatit kushtetues dhe nevojën për hartimin e një traktati të ri. Vendimi përfundimtar për hartimin e një traktati të ri u mor në fund të vitit 2008.

Me 1 Janar 2008, Rumania dhe Bullgaria iu bashkuan Bashkimit Evropian, pas një periudhe të gjatë negociatash mes palëve e që ishte si rezultat i ngecjes së vendeve respektive në permbushjen e kriterëve për anëtarësim.


Përfundimisht, në vitin 2009 hyn në fuqi Traktati i Lisbonës, i cili bën ndryshimin e tri traktateve: Traktatit të Mاستrihtit (1993), Traktatit të Bashkimit Evropian (2007) dhe Traktatit të Romës (1957), e modifikuar me vonë në Traktatin për funksionimin e Bashkimit Evropian (2007). Ky traktat sjell disa risi strukturore institucionale duke prezantuar dy poste afatgjate: Presidentin e Këshillit Evropian dhe Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë; bën modifikimin e mënyrës së votimit për mëse 45 fusha, ku Këshilli nuk do të votojë me me unanimitet, por me shumicë të kualifikuar; fuqizoi Parlamentin Evropian duke e formësuar si legjislaturë bikamerale nën procedurën e bashkëvendim-marrjes si dhe bëri një konsolidim të personalitetit legal të Bashkimit Evropian. Traktati i Lisbonës bëri edhe një hap përpara në avansimin e fushës së të drejtave të njeriut duke bërë kështu obligative Kartën e të drejtave themelore. Me këtë Traktat parashikohet edhe e drejta e shteteve anëtare për të dalë nga Bashkimi si dhe procedura e daljes. Mbi bazën e kësaj të drejte në vitin 2016, Britania e madhe mbajti një referendum për të vendosur për dalje nga BE-ja. Procesi i daljes së Britanisë nga BE-ja do të shoqërohet me negociata intenzive dhe do të ketë ndryshime legjislative në Britani por edhe në BE.

Më datë 1 Korrik 2013 Kroacia bëhet anëtar i 28-të i Bashkimit Evropian, duke shënuar integrimin e dytë nga shtetet e ish-Jugosllavisë.

Në mes të viteve 2013-2016 Bashkimi Evropian ka kaluar nëpër një krizë ekonomike të manifestuar në mënyrë më të theksuar në Greqi. Kjo krizë është menaxhuar nga BE duke vënë një sërë masash dhe kufizimesh për Greqinë.

2

2. Arkitektura institucionale e Bashkimit Evropian



2.1 Këshilli Evropian

Roli: Institucion ndërqeveritar që përcakton drejtimin e përgjithshëm politik të BE-së

Themeluar më: 1974 (trupë politike), 2009 (institucion I BE-së)

Përbërja: Përfaqësuesit më të lartë të cdo shteti anëtar, Presidenti i Këshillit Evropian dhe Presidenti i Komisionit Evropian

Mandati: 2,5 vjet

Selia: Bruksel



7. Nga Samiti i Maltës i Këshillit evropian, 3 shkurt 2017, Maltë

Këshilli evropian është institucioni më i lartë formal i cili fillimisht ishte takim joformal i përfaqësuesve më të lartë të shteteve anëtare. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës më 1 dhjetor 2009 përcaktohet që Këshilli evropian të mbetet organi më i lartë i përfaqësimit, të cilin do t'a udhëheq Presidenti i Këshillit Evropian, post ky që është prezantuar për herë të parë me këtë Traktat.

Përbërja dhe kompetencat

Këshilli evropian përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha shteteve anëtare, përkatësisht nga kryetarët e shteteve apo kryeministrat varesisht nga sistemi politik i shtetit anëtar. Këshilli takohet dy herë në vit dhe në mbledhjet e tij merr pjesë edhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë. Mbledhjet kryesohen nga Presidenti i Këshillit, i cili ka një mandat prej dy vjet e gjysmë. Takimet e këtij Këshilli zhvillohen për tema të rëndësishme, që kanë karakter qenësor për BE-në.

Këshilli evropian ka këto kompetenca:

- 1** Përcakton prioritetet dhe objektivat e përgjithshme politike të Bashkimit dhe në këtë kontekst i jep Bashkimit impulse të domosdoshme për zhvillimin e tij. Ai nuk ka kompetenca legjislative.
- 2** Siguron përgatitjen dhe vazhdimësinë e punës së Këshillit evropian së bashku me Presidentin e Komisionit evropian dhe në bazë të punës së Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme.
- 3** Siguron dhe lehtëson kohezion dhe konsensus në Këshillin Evropian.
- 4** Siguron brenda kompetencave të tij, përfaqësimin e jashtëm të Bashkimit në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me politikën e jashtme dhe të sigurisë.
- 5** Prezanton raport informues për Parlamentin Evropian pas çdo mbledhje.

Përkrahimi ligjor i kompetencave të Këshillit Evropian bëhet me Nenin 15, pika 1 e Traktatit themelues të Bashkimit Evropian, në të cilin përkrahur qartë se roli i Këshillit është për të përcaktuar drejtimit e përgjithshme të Bashkimit Evropian, por duke mos pasur rol legjislativ. Kompetencat e tij fokusohen posaqërisht në Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë si dhe emërimin e funksionimit të institucioneve të tjera. Këshilli evropian merr pjesë me rastin e emërimit të Komisionit Evropian dhe përcakton radhën e drejtimit të presidencës së Këshillit të BE-së. Ai gjithashtu merr pjesë në procesin e anëtarimit dhe të daljes së një vendi nga BE-ja.

Këshilli Evropian vendimet e veta i merr me konsensus dhe në disa raste të veçanta edhe me shumicë të thjeshtë apo absolute.

2.2 Këshilli i (ministrave) të BE-së

- Roli:** Institucion ndërqeveritar me rol legjislativ dhe ekzekutiv
- Themeluar më:** 1952, 1958 (i ndarë nga tri Komunitetet), 1967 (si Këshill i veçantë)
- Përbërja:** Qeveritë e shteteve anëtare (mbledhjet kanë format në bazë të temave të diskutimit në mbledhje); 10 konfiguracione tematike të Këshillit
- Presidenca:** me rotacion në mes të shteteve anëtare (periudhë 6 mujore)
- Struktura:** Grupet punuese (përafersisht 160), Komitetet, COREPER, Këshilli i Ministrave, Sekretariati i Përgjithshëm I Këshillit
- Selia:** Bruksel, Luksemburg dhe kryeqytetet e shteteve anëtare



8. Ndërtesa e Këshillit të BE-së

Këshilli i ministrave, i njohur edhe me emrin Këshilli, është organ kryesor vendimmarrës i BE-së, i përbërë nga qeveritë, përkatësisht nga ministrat e vendeve anëtare. Këshilli mblidhet për të diskutuar, pajtuar, ndryshuar dhe për të marrë vendime; miratuar legjislacion; koordinojë politika të shteteve anëtare; ose të definojë politikat e jashtme të BE-së. Këshilli përbëhet prej 28 anëtarëve, të cilët nuk janë të përhershëm me mandate të pakufizuara dhe përfaqësojnë shtetet anëtare. Në çdo mbledhje merr pjesë nga një apo dy anëtarë nga Komisioni, gjithashtu në mbledhje marrin pjesë edhe bashkëpunëtorë profesionalë të Komisionit dhe Këshillit. Varësisht se çfarë teme ka në agjendë për diskutim Këshilli, ftohen për pjesëmarrje ministrat e resorit përkatës dhe kjo njihet si 'konfiguracioni' i Këshillit. Nëse, për shembull, Këshilli duhet të diskutojë çështjen e ekonomisë dhe financave, në mbledhje do të marrin pjesë ministrat e ekonomisë dhe financave të çdo vendi të BE-së dhe kjo mbledhje njihet si 'Këshilli i Ekonomisë dhe financave'; e njëjta vlen edhe për 'Këshillin e Çështjeve të Mjedisit' ose 'Këshilli i Konkurrencës', etj. Presidenca e Këshillit ndërrohet në mes shteteve anëtare çdo gjashtë muaj. Përgjegjësia e qeverisë së shtetit anëtar që mban Presidencën është të organizojë dhe të kryesojë mbledhje të ndryshme të Këshillit. Çdo ministër në Këshill e përfaqëson qeverinë e vet, me ç'rast çdo nënshkrim i ministrit nënkupton miratim nga tërë qeveria, të cilën ministri e përfaqëson. Përjashtimisht, Këshilli i Punëve të Jashtme kryesohet nga Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri, i cili kryen politikën e jashtme në emër të Këshillit. Për të siguruar vazhdimësi të punës së Këshillit, Presidencat gjashtë mujore punojnë së bashku në grupe me nga tri presidenca. Këto ekipe me tri-Presidenca ('trio') hartojnë program të përbashkët të punës së Këshillit për një periudhë 18 mujore.



9. Mbledhja e Këshillit të Ministrave

Puna e Këshillit përcaktohet me rregulloren e këtij institucioni dhe zhvillohet në tri faza:

Përgaditja e mbledhjeve të Këshillit bëhet përmes dy organeve të përhershme në strukturën organizative: Komiteti i Përfaqësuesve të përhershëm dhe Sekretariati i Përgjithshëm.

Mbledhjet e Këshillit të BE-së ishin të mbyllura për një kohë të gjatë për publikun, tani publikohen vendimet e Këshillit mirëpo jo edhe përmbajtja e diskutimeve, qëndrimeve të kundërta.

Vendimet e Këshillit sillen në formë të rregulloreve, direktivave, vendimeve, rekomandimeve dhe mendimeve.

Këshilli ka pesë funksione:

1. Të miratojë legjislacionin evropian, në shumicën e fushave. Në fusha të caktuara nxjerr ligje së bashku me Parlamentin Evropian. Këshilli vepron vetëm mbi propozimet e Komisionit, ndërsa Komisioni zakonisht mban përgjegjësinë për zbatimin e drejtë të legjislacionit të BE-së pas miratimit.

2. Këshilli ka përgjegjësinë e garantimit të politikave ekonomike të shteteve anëtare. Ai i koordinon shtetet anëtare , përkatësisht Ministrat e shteteve anëtare .

3. Në bashkëpunim me Parlamentin evropian, Këshilli miraton buxhetin vjetor të BE-së. Në rastin kur ka mosmarrëveshje në mes të Parlamentit dhe Këshillit lidhur me buxhetin e propozuar, atëherë ndiqen procedurat e pajtimit deri sa të miratohet buxheti.

4. Këshilli në bazë të udhëzimeve që merr nga Këshilli evropian, koordinon me shtetet anëtare Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë. Në këtë fushë shtetet mbeten sovrane sa i përket Politikës së Jashtme dhe Sigurisë, edhe pse në Këshill gjithmonë shtetet anëtare angazhohen për koordinim të veprimeve të përbashkëta.

5. Të lidhë marrëveshje ndërkombëtare mes BE-së dhe një ose më shumë shteteve ose organizatave ndërkombëtare në fusha të ndryshme, si: atë të tekstilit, shkencës dhe teknologjisë, transportit, tregtisë, bashkëpunimit dhe zhvillimit. Këto marrëveshje ratifikohen në Parlamentin Evropian, në fushat ku vendimmarrja është e përcaktuar me bashkë-vendimmarrje.

6. Këshilli kordinon bashkëpunimin e shteteve anëtare në fushën e forcave policore dhe gjykatave nacionale lidhur me çështet penale, lirinë, sigurinë dhe drejtësinë.

Ekzistojnë dhjetë formate të ndryshme të Këshillit:

- Takimet e kryesura nga Përfaqësuesi i Lartë për Punë të Jashtme dhe Politikë Sigurie
- Punët e Jashtme Kryesuar nga Shtetet anëtare që mbajnë Presidencën e Këshillit
- Çështjet e përgjithshme
- Çështjet e ekonomike dhe financiare
- Gjyqësia dhe punët e brendshme
- Punësimi, politika sociale, shëndetësia dhe çështjet e konsumatorëve
- Konkurrenca (tregu i brendshëm, industria, hulumtimi dhe hapësira)
- Transporti, Telekomunikacioni dhe Energjia
- Bujqësia dhe Peshkataria
- Mjedisi
- Arsimi, Rinia, Kultura dhe Sporti

Mënyra e vendimmarrjes në Këshill:

Në varësi të çështjeve për diskutim, Këshilli i BE-së merr vendimet e tij në këto mënyra:

1. Me shumicë të thjeshtë (15 shtete anëtare votojnë në favor)
2. Me shumicë të kualifikuar (55% e shteteve anëtare, që përfaqësojnë të paktën 65% të popullsisë së BE-së, votojnë në favor)
3. Me votim unanim (të gjitha votat janë në favor)

Këshilli mund të votojë vetëm nëse janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij. Një anëtar i Këshillit mund të votojë vetëm në emër të tij.


Këshilli mund të votojë për një akt legjislativ deri në 8 javë pasi drafti është dërguar në parlamentet kombëtare për shqyrtimin e tyre. Parlamentet kombëtare duhet të vendosin nëse projektligji është në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Votimi i mëhershëm është i mundur vetëm në raste të veçanta urgjente.

Votimi inicohet nga Presidenti i Këshillit. Një anëtar i Këshillit ose Komisionit mund të iniciojë gjithashtu procedurën e votimit, por shumica e anëtarëve të Këshillit duhet ta miratojnë këtë iniciativë.

Rezultatet e votave të Këshillit publikohen automatikisht kur Këshilli vepron në cilësinë e tij si ligjvënës.

Nëse një anëtar dëshiron të shtojë një shënim shpjegues për votimin, ky shënim do të bëhet edhe publik. Në raste të tjera, kur shpjegimet e votave nuk publikohen automatikisht, ato mund të bëhen publike me kërkesë të veçantë.

Kur Këshilli nuk vepron si ligjvënës, është gjithashtu e mundur që rezultatet e votave dhe shpjegimet e votimit të bëhen publike me vendim unanim të Këshillit. Anëtarët e Këshillit dhe të Komisionit mund të bëjnë deklarata dhe të kërkojnë që ato të përfshihen në procesverbalin e Këshillit. Deklarata të tilla nuk kanë efekt ligjor dhe konsiderohen si një instrument politik që synon lehtësimin e vendimmarrjes.



9. Mënyra e vendimmarrjes brenda Këshillit (<http://hum.port.ac.uk>)

2.3 Parlamenti Evropian

Roli: Institucioni më i lartë legjislativ

Themeluar më: 1979 (i zgjedhur), 1952 si Asamble e Përbashkët

Përbërja: 751 deputetë të zgjedhur drejtpërsëdrejti

Presidenca: Një kryetar dhe 14 nënkryetar

Grupet parlamentare: EPP, S&D, ECR, ALDE, GUE/NGL, Greens/EFA
GUE/NGL, Greens/EFA, EFDD, NI
(shih përshkrimin në skemën 13)

Mandati: 5 vjet

Struktura: 20 komisione të përhershme, 35 Delegacione,
përafërsisht 5000 zyrtarë administrativ

Gjuhë zyrtare: 24

Selia: Strazburg, Bruksel dhe Luksemburg



10. Ndërtesa e Parlamentit evropian, Strasburg

Parlamenti evropian (EP ose Parlamenti) është një nga institucionet më të rëndësishme vendimmarrëse të Bashkimit Evropian. Parlamenti është institucion legjislativ, i cili së bashku me Këshillin evropian miraton ligjet/aktet ligjore të BE-së. Që nga krijimi i Komunitetit të Qymyrit dhe Çelikut në vitin 1952, ku fillimisht quhej Asamble, Parlamenti evropian deri sot ka pësuar ndryshime thelbësore në përbërje dhe në kompetenca. Si rezultat i rishikimeve që pësuan traktatet themeluese, Parlamenti evropian u shëndrrua nga një organ konsultativ në një organ të mirëfilltë (bashkë) ligjvënës.

Selia zyrtare e Parlamentit Evropian është në Strazburg, Francë. Por, Parlamenti evropian ka edhe dy seli të tjera të punës: në Bruksel dhe Luksemburg, përderisa mbledhjet kryesore të Parlamentit në tërësi, të quajtura 'seanca plenare', mbahen në Strazburg cdo muaj. Në Bruksel mbahen seancat plotësuese plenare dhe mbledhjet e Komiteteve.

Selia zyrtare e Parlamentit Evropian është në Strazburg, Francë. Por, Parlamenti evropian ka edhe dy seli të tjera të punës: në Bruksel dhe Luksemburg, përderisa mbledhjet kryesore të Parlamentit në tërësi, të quajtura 'seanca plenare', mbahen në Strazburg cdo muaj. Në Bruksel mbahen seancat plotësuese plenare dhe mbledhjet e Komiteteve.

Parlamenti evropian ndryshon nga parlamentet kombëtare (si p.sh. parlamenti gjerman, parlamenti francez, etj.), pasi zotëron vetëm disa kompetenca të kufizuara parlamentare. Të drejtat që zotëron Parlamenti evropian në kuadër të procedurave ligjvënëse varen nga fusha politike, për të cilat merret vendimi. Këto të drejta shtrihen nga njoftimi dhe seancat dëgjimore deri te bashkëpunimi në ligjvënien evropiane. Përmes politikës buxhetore, Parlamenti evropian mund të ushtrojë ndikimin më të madh mbi disa fusha të rëndësishme të politikës.



11 .Salla e mbajtjes së seancave parlamentare, Louise Èeis, Strazburg

Etapa të rëndësishme kanë qenë zgjerimi i kompetencave të Parlamentit Evropian në çështjet e buxhetit (1975), futjen e procedurës së bashkëpunimit (1986) dhe asaj të bashkëvendim-marrjes (1992) si dhe ndryshimeve vijuese të traktatit; një zgjerim i konsiderueshëm i fushave, ku gjen zbatim procedura e bashkëvendim-marrjes. Gjatë viteve, është rritur numri i anëtarëve të Parlamentit evropian, për shkak të anëtarimit të shteteve të reja, me ç'rast është rritur edhe rëndësia e parlamentit evropian.

Pas viteve 1990-të Parlamenti mori kompetenca të mëdha në fushën legislative dhe në atë të mbikëqyrjes. Nga kjo kohë u shënuar një 'luftë' e vazhdueshme në mes deputetëve të Parlamentit me organet tjera burokratike të BE-së për marrje të më shumë kompetencave. Në këtë mënyrë deputetët kanë shënuar sukses duke vënë përpara nevojën e zhvillimit të demokracisë parlamentare. Pas futjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës kemi një rritje të konsiderueshme të kompetencave të Parlamentarëve Evropian. Kjo ka të bëjë me faktin, që është rritur aplikimi i procedurës së rregullt legislative, e cila ka zëvendësuar procedurën e mëparshme të bashkëvendimmarrjes e që aplikohet tani në shumicën e rasteve: në politikat e përbashkëta bujqësore; në bashkëpunimin policor; bashkëpunim në çështje të drejtësisë në kuadër të çështjeve penale, etj. Procedura e rregullt legislative, e përshtatur në nenin 294 të Traktatit, rreth mënyrës së funksionimit të Bashkimit Evropian, e bën Parlamentin në kontekstin e procedurave ligjvënëse një institucion me të drejta të barabarta me Këshillin e BE. Kjo, e shprehur më thjeshtë, do të thotë që asnjëri nga këto dy institucione nuk mund të nxjerrë një ligj pa miratimin e tjetrit.

Parlamentit evropian i njihen më shumë kompetenca të reja edhe sa i përket kompetencës klasike parlamentare, miratimit të buxhetit vjetor, i cili më pas menaxhohet nga Komisioni evropian. Parlamenti luan një rol të rëndësishëm për ndarjen buxhetore, atëherë kur shtetet anëtare por edhe parlamentarët kanë vërejtje rreth ndarjes së buxhetit.

Parlamenti voton poashtu kërkesën e shteteve kandidate për anëtarësim në BE, e paraparë më Nenin 49, sipas të cilit

“Çdo shtet evropian mund të bëjë kërkesën për t’u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Kërkesa i dorëzohet Këshillit i cili duhet të vendosë njëzëri pasi ka dëgjuar Komisionin dhe ka marrë miratimin e Parlamentit Evropian, i cili merr vendimin e vet me shumicë (të paktën 50% +1 të të gjithë deputetëve)“.

Parlamenti evropian ka tri role kryesore:

1. Rolin ligjbërës: Bashkë me Këshillin, Parlamenti ndan pushtetin e nxjerrjes apo miratimin e legjislacionit. Duke qenë se është organ i zgjedhur drejtpërsëdrejti nga qytetarët e BE-së, garanton legjitimitetin demokratik të së drejtës evropiane.

Parlamenti evropian miraton legjislacionin në disa mënyra, varësisht nga fushat për të cilat merret vendimi. Procedura më e zakonshme për miratimin e legjislacionit të BE-së quhet 'procedurë e zakonshme legjislative' — e njohur edhe si 'procedurë e bashkë vendim-marrjes'. Kjo e vendos Parlamentin Evropian dhe Këshillin në pozitë të barabartë vendimmarrëse dhe ligjet e nxjerra me këtë procedurë janë akte të përbashkëta të Këshillit dhe Parlamentit. Kjo vlen për pjesën më të madhe të legjislacionit të BE-së që përfshin shumë fusha të ndryshme, siç janë të drejtat e konsumatorit, mbrojtja e mjedisit dhe transporti. Sipas procedurës së zakonshme legjislative, miratimi i ligjeve të përgatitura nga Komisioni është i nevojshëm nga Parlamenti dhe nga Këshilli. Komisioni dërgon në të njejtën kohë propozimet në të dyja institucionet për marrjen e aprovimit. Parlamenti miraton poashtu marrëveshjet ndërkombëtare që trajtojnë çështje të parapara me procedurën e zakonshme legjislative. Komisioni duhet të konsultojë Parlamentin në shumë çështje të tjera, por obligohet të kërkojë miratimin e Parlamentit për çështjet si: siguria sociale dhe aktet e mbrojtjes, dispozitat lidhur me tatimet në fushën e energjisë dhe harmonizimi i taksave të qarkullimit me taksat indirekte. Parlamenti ka të drejtën e stimulimit të legjislacionit të ri duke i kërkuar Komisionit të prezantojë propozime.

2. Fuqia e mbikqyrjes: Bën mbikqyrje demokratike të të gjitha institucioneve të BE-së dhe sidomos ndaj Komisionit evropian. Ka fuqinë e miratimit ose refuzimit të nominimeve të Presidentit të Komisionit dhe të komisionerëve dhe të drejtën për të ndërruar Komisionin si tërësi.

Së pari, Parlamenti voton Komisionin e ri duke i testuar të gjithë anëtarët e rinj-komisionerët dhe Presidentin e Komisionit, cilët janë të nominuar paraprakisht nga shtetet anëtare.

Komisioni i përgjigjet politikisht Parlamentit, i cili mund ta thërret në përgjegjësi Komisionin dhe të kërkojë dorëheqjen e tij.

Parlamenti shqyrton rregullisht raportet nga Komisioni dhe poashtu parashtron pyetje me shkrim dhe me gojë për komisionerët. Varësisht nga resori që mbulojnë dhe çështjet për diskutim, komisionerët marrin pjesë në seancat plenare të Parlamentit dhe në mbledhjet e komiteteve parlamentare.

3. Miratimi i buxhetit: Bashkë me Këshillin, ndan autoritetin mbi buxhetin e BE-së dhe prandaj mund të ndikojë në shpenzimet e BE-së. Parlamenti, në fund të procedurës buxhetore, miraton ose refuzon tërësisht buxhetin.

Përbërja dhe mënyra zgjedhjes së deputetëve të Parlamentit Evropian

Parlamenti evropian është institucioni i vetëm i Bashkimit evropian që zgjidhet direkt nga qytetarët që nga viti 1979. Zgjedhjet organizohen nga BE në bashkëpunim me shtetet anëtare, në sistemet zgjedhore që kanë secili shtet dhe të ndara në zonat zgjedhore ashtu siç i kanë shtetet anëtare .

Zgjedhjet mbahen çdo pesë vite dhe të gjithë qytetarët e BE-së - rreth 380 milionë, mbi moshën 18 vjeçare kanë të drejtë vote.

Traktati i Lisbonës vendosi rritjen e numrit të deputetëve nga 736 sa kishte më parë në 750 plus Kryetarin e Parlamentit. Sot, Parlamenti evropian përbëhet nga 751 deputetë që vijnë nga 28 shteteve anëtare të BE-së.

Me Lisbonën numri maksimal i deputetëve për një vend anëtar u reduktua nga 99 në 96 (masë, prej të cilës u prek Gjermania), ndërsa numri minimal u ngrit nga 5 në 6 (masë, prej të cilës ka përfituar Malta).

Numri i përgjithshëm u kufizua në 750 deputetë plus Kryetarin e Parlamentit (në vend të 736, që ishin në zgjedhjet për Parlamentin Evropian në vitin 2009).

Ulëset në Parlamentin evropian ndahen midis shteteve anëtare në bazë numrit të popullatës. Anëtarët e PE-së organizohen në grupime/grupe të ndryshme të partive politike. Të gjitha këto grupe parlamentare të partive politike përbëhen nga parti politike me orientime ideologjike të njëjta nga të gjitha shtetet anëtare, që ndryshe quhen edhe fraksione. Këto fraksione propozojnë listen e kandidatëve për zgjedhje dhe prezantojnë platforma zgjedhore me të cilat garojnë.

Traktati i Lisbonës ndryshon edhe mënyrën e shpërndarjes së vendeve në mes të shteteve anëtare. Tabela e mëposhtme tregon shpërndarjen e vendeve në Parlamentin evropian në zgjedhjet e vitit 2019 sipas shteteve:

Distribution of seats in the European Parliament


The number of MEPs per country has been modified following the UK's departure from the EU at the end of January 2020



Duke qenë se vendimet në BE merren nga Parlamenti dhe Këshilli, atëherë për anëtarët e Parlamentit është e pashmangshme bashkëpunimi në mes të grupeve parlamentare të të gjitha partive politike, në mënyrë që të ushtrjnë më pas presion mbi Këshillin. Për këtë arsye rekomandohet, që koha mes seancave dhe diskutimeve në Këshill të shfrytëzohet për biseda me kolegë për të gjetur një pozicion me përkrahje sa më të gjerë.

Në Parlamentin evropian ekzistojnë shtatë grupe të partive politike (fraksione) dhe një grup i deputetëve të pavarur: Grupi i Partive Popullore Evropiane (PPE), Grupi Aleanca Progresive e Socialisteve dhe Demokratëve të Bashkimit Evropian (S dhe D), Grupi i të Të Gjelbërve në Parlamentin Evropian (Të Gjelbërit), Grupi i partive liberale dhe demokratike (ALDE), Grupi Federal i të Majtës së Bashkuar Evropiane / të Majtës së Gjelbër të Veriut (VEL/NGL), Grupi i evropianëve konservativ dhe reformist, Grupi Evropa e lirisë dhe demokracisë ose deputetëve pa grup. Secili anëtar i Parlamentit evropian- deputeti, përfaqëson idetë politike të fraksionit, pjesë e së cilit është dhe realizon politika në bazë të vendimmarrjes në Parlament.

Në tabelën e mëposhtme janë rezultatet e zgjedhjeve të fundit (viti 2019) sipas grupeve të partive politike/fraksioneve:



12. Ndarja e vendeve në bazë të grupeve të partive politike/fraksioneve në zgjedhjet e vitit 2014: (Deutsche Welle, Burimi: results-elections2014.eu; rezultatet preliminare) <https://www.europarl.europa.eu/news/en/press-room/20190523IPR52406/election-2019-updated-seat-projection-for-new-parliament>

2.4 Komisioni evropian

Roli: Institucion mbikombëtar me fuqi ekzekutive; monopol në propozim të legjislacionit; gardian i së drejtës evropiane; promovim të BE-së

Themeluar më: 1958

Përbërja: Kolegji i Komisionerëve (28), nga çdo shtet antëtar, të zgjedhur nga Parlamenti evropian

Presidenca: Presidenti; Zëvendës Presidenti i parë, Zv. Presidenti dhe Udhëheqësi i Lartë i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë dhe 5 Zëvendës Presidentë të tjerë

Struktura organizative: 42 Drejtorate dhe Shërbime me përafërsisht 30,000 zyrtarë

Mandati: 5 vjeçar (aktualisht mandate 2014-2019)

Gjuhët zyrtare: Gjuha angleze, franceze dhe gjermane

Selia: Bruksel dhe Luksemburg



14. Selia e Komisionit evropian, Bruksel

Komisioni Evropian është institucion mbikombëtar, i pavarur, qëllimi i së cilit është përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të Bashkimit Evropian si tërësi. Natyra mbikombëtare e Komisionit Evropian pasqyrohet në parimin e integritimit evropian dhe karakterin mbikombëtar qeverisës. Komisioni asociohet me 'qeverinë' e një shteti anëtar, për shkak të kompetencave ekzekutive që bartë, por edhe për shkak të së drejtës ekskluzive për propozimin e legjislacionit, implementimit të buxhetit dhe politikave në nivel të BE-së.

Në shumë fusha, Komisioni është forca shtytëse përbrenda sistemit institucional të BE-së e që kryen disa funksione: propozon legjislacionin, harton politika dhe programe për veprim dhe është përgjegjës për implementimin e vendimeve të Parlamentit dhe Këshillit Evropian. Ai ka për qëllim që të balancojë interesat e shteteve anëtare që adresohen nga Këshilli Evropian, Këshilli i Ministrave, por edhe nga vet shtetet anëtare. Ai gjithashtu përfaqëson Bashkimin Evropian në botën e jashtme, me përjashtim të politikës së përbashkët për punë të jashtme dhe siguri.

Komisionerët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pavarësi të plotë, gjatë zbatimit të detyrimeve; ata nuk lejohen të kërkojnë apo pranojnë udhëzime nga qeveritë apo institucionet e tjera. Ata duhet të heqin dorë nga çdo veprim që shkakton konflikt interesi me detyrat dhe ushtrimin e funksioneve të tyre.

Si rezultat i proceseve integruese, Komisioni Evropian ka kaluar nëpër disa faza të zhvillimit. Fillimisht, Komisioni Evropian u quajt Autoriteti i lartë udhëheqës roli i të cilit ishte adiminstrativo-ekzekutiv. Shtetet nuk deshironin që Autoriteti i lartë të forcohej me kompetenca mbishtetërore.

Me traktatet për Euroatom-in dhe për KEE-në u bënë ndryshime në rolin dhe pozicionin e Komisionit gjatë realizimit të proceseve integruese me ç'rast iu besua roli i iniciatorit dhe përgaditësit të së drejtës së komunitetit. Kjo do të thotë se Komisioni evropian është i vetmi institucion që bartë të drejtën për iniciimin e legjislacionit. Përveq kësaj Komisionit iu besua marrja e kompetencave për përkujdesjen e realizimit të akteve juridike të Komunitetit.

Me Aktin Unik Evropian, Komisioni evropian e fitoi rolin e tërësishëm për iniciimin e legjistacionit të Komunitetit, që më së miri u vërtetua në iniciativën për formimin e Bashkimit Monetar dhe Ekonomik.

Traktati i Mastrihtit kishte për qëllim të përmirësonte pozicionet e Komisionit, zgjerimin e çështjeve mbi të cilat do të shtriheshin kompetencat e tij. Rreth statusit të Komisionit nuk u bënë ndryshime të rëndësishme dhe as ndonjë rishpërndarje e kompetencave në mes Këshillit dhe Komisionit. Një ndër detyrat primare të Komisionit, ishte realizimi i objektivave të cilat ishin të caktuara me traktate.

Në përforcimin e rolit të Komisionit evropian kontribuan gjithashtu Traktati i Amsterdimit dhe ai i Nicës, duke zgjeruar listën e fushave politike për të cilat mund të inicoheshin propozime ligjore.

Përbërja dhe procedura e emërimit të anëtarëve të Komisionit Evropian

Me traktatet e Parisit dhe Romës ishte parashikuar që në përbërjen e Komisionit të kishte të paktën një komisioner nga një shtet anëtar dhe jo më shumë se dy komisionerë (Gjermania, Britania e Madhe, Italia, Spanja dhe Franca).

Europäische Kommission

 JEAN-CLAUDE JUNCKER PRÄSIDENT	 FRANS TIMMERMANS ERSTER VIZEPRÄSIDENT Europäische Rechtsprechung, interinstitutionelle Beziehungen, Rechtsstaatlichkeit und die Grundrechtswächter	 FEDERICA MOGHERINI VIZEPRÄSIDENTIN HOCHRECHTSPREISERIN der Union für Außen- und Sicherheitspolitik
 KRISTALINA GEORGIEVA VIZEPRÄSIDENTIN Wirtschaft und Personal	 ANDRUS ANSIP VIZEPRÄSIDENT Digitaler Binnenmarkt	 HAROŠ ŠEFČOVIČ VIZEPRÄSIDENT Energieunion
 GÜNTHER OETTINGER Zusatz-Präsident und Vizepräsident	 JOHANNES HAHN Europäische Nachbarn, Handelspolitik und Entwicklungszusammenarbeit	 CECILIA MALMSTRÖM Handel
 KARMENU VELLA Umwelt, Meerespolitik und Fischerei	 VYTENIS ANDRIUKAITIS Gesundheit und Lebensmittelsicherheit	 DIMITRIS AVRAMOPOULOS Migration, Innere und Regionalpolitik
 CHRISTOS STYLIANIDES Regionalpolitik und Regionalentwicklung	 PHIL HOGAN Landwirtschaft, ländliche Entwicklung	 JONATHAN HILL Finanzstabilität, Finanzen, Eurozonen und Finanzdienstleistungen
 VĚRA JOUROVÁ Justiz, Verbraucher und Gleichstellung	 TIBOR NAVRÁCSICS Bildung, Kultur, Jugend und Sport	 CORINA CREȚU Regionalpolitik
 VALDIS DOMBROVSKIS Euro und stabiler Dialog	 NEVJEN MIMICA Internationale Zusammenarbeit und Entwicklung	 MARIANNE THYSSSEN Beschäftigung, Soziales, Gleichberechtigung und Arbeitsmarkterneuerung
 JYRKI KATAINEN VIZEPRÄSIDENT Abgabepolitik, Wettbewerb und Arbeitsmarkterneuerung	 MIGUEL ARIAS CAÑETE Klimapolitik und Energie	 PIERRE MOSCOVICI Wirtschafts- und Finanzpolitik, Wachstum, Soziales und Justiz
 ELŻBIETA BIENKOWSKA Binnenmarkt, Industrie, Entrepreneurship und IKT	 CARLOS MOEDAS Forschung, Wissenschaft und Innovation	

Europäische Kommission 2014-2019 #teamJunckerEU

Komisioni evropian përbëhet nga 28 anëtarë (Kolegji i komisionerëve), të cilët emërohen nga Këshilli Evropian një herë në pesë vjet, brenda 6 muajve nga data e zgjedhjeve për Parlamentin Evropian. Gjatë mandatit pesë vjeçar, anëtarëve të Komisionit nuk u lejohet ushtrim i veprimtarive tjera. Përpara mbarimit të mandatit, anëtarët e Komisionit mund të japin dorëheqje apo mund të shkarkohen nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Mirëpo, mund të ndodhë që me aprovim të kolegjiut, me kërkesë të kryetarit të Komisionit ndonjërit nga anëtarët individualisht t'i urdhërohet të jap dorëheqjen.

Anëtarët e Komisionit janë të njohur joformalisht si “komisionerë” dhe të gjithë ata kanë pasur pozita politike paraprakisht në shtetet e tyre. Një numër i madh i tyre kanë qenë ministra, por që në pozitën e anëtarit të Komisionit ata obligohen të veprojnë vetëm për interesat e Bashkimit duke mos pranuar urdhëra apo interesa nga qeveritë nacionale.

Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit janë të renditura këto kushte: shtetësia e njërit nga shtetet anëtare të BE-së, kompetencat e kandidatit, aftësia e përgjithshme dhe pavarësia.

Komisioni mbetet politikisht përgjegjës para Parlamentit, i cili ka fuqinë ta shkarkojë me anë të miratimit të një shkrese të kundërshtimit. Komisioni merr pjesë në të gjitha seancat e Parlamentit, ku duhet të sqarojë dhe të justifikojë politikat e veta. Ai gjithashtu rregullisht i përgjigjet pyetjeve me shkrim dhe me gojë, të parashtruara nga deputetët e Parlamentit.

Emërimi i Komisionit evropian: Qeveritë e shteteve anëtare fillimisht bien dakord të propozojnë kryetarin e Komisionit, pastaj Parlamenti evropian duhet të jap mendim pozitiv për kandidatin e propozuar që do të thotë të aprovojë kandidaturën e tij. Pas këtij procesi, ekipi i propozuar i Komisionit i kryesuar nga kryetari shkon në “dëgjim” në Parlamentin Evropian. Parlamenti duhet të jep mendimin pozitiv ose negativ. Nëse Parlamenti jep mendimin pozitiv, Komisioni emërohet në takimin e përfaqësuesve të qeverive të shteteve anëtare në Këshillin Evropian, në të kundërtën nëse Parlamenti evropian jep mendim negativ e tërë proceduara nis nga fillimi.

Komisionin e udhëheq presidenti i ndihmuar nga disa zëvendës-presidentë. Përzgjedhjen e komisionerëve e bën presidenti i Komisionit. Komisionerëve u ndahen kompetencat në mënyrë që secili prej tyre të përgjigjet për një fushë të caktuar. Presidenti i Komisionit Evropian është edhe anëtar i Këshillit Evropian.

Komisioni evropian përbëhet nga 28 anëtarë (Kolegji i komisionerëve), të cilët emërohen nga Këshilli Evropian një herë në pesë vjet, brenda 6 muajve nga data e zgjedhjeve për Parlamentin Evropian. Gjatë mandatit pesë vjeçar, anëtarëve të Komisionit nuk u lejohet ushtrim i veprimtarive tjera. Përpara mbarimit të mandatit, anëtarët e Komisionit mund të japin dorëheqje apo mund të shkarkohen nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Mirëpo, mund të ndodhë që me aprovim të kolegjiut, me kërkesë të kryetarit të Komisionit ndonjërit nga anëtarët individualisht t'i urdhërohet të jap dorëheqjen.

Anëtarët e Komisionit janë të njohur joformalisht si “komisionerë” dhe të gjithë ata kanë pasur pozita politike paraprakisht në shtetet e tyre. Një numër i madh i tyre kanë qenë ministra, por që në pozitën e anëtarit të Komisionit ata obligohen të veprojnë vetëm për interesat e Bashkimit duke mos pranuar urdhëra apo interesa nga qeveritë nacionale.

Për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit janë të renditura këto kushte: shtetësia e njërit nga shtetet anëtare të BE-së, kompetencat e kandidatit, aftësia e përgjithshme dhe pavarësia.

Komisioni mbetet politikisht përgjegjës para Parlamentit, i cili ka fuqinë ta shkarkojë me anë të miratimit të një shkrese të kundërshtimit. Komisioni merr pjesë në të gjitha seancat e Parlamentit, ku duhet të sqarojë dhe të justifikojë politikat e veta. Ai gjithashtu rregullisht i përgjigjet pyetjeve me shkrim dhe me gojë, të parashtruara nga deputetët e Parlamentit.

Emërimi i Komisionit evropian: Qeveritë e shteteve anëtare fillimisht bien dakord të propozojnë kryetarin e Komisionit, pastaj Parlamenti evropian duhet të jap mendim pozitiv për kandidatin e propozuar që do të thotë të aprovojë kandidaturën e tij. Pas këtij procesi, ekipi i propozuar i Komisionit i kryesuar nga kryetari shkon në “dëgjim” në Parlamentin Evropian. Parlamenti duhet të jep mendimin pozitiv ose negativ. Nëse Parlamenti jep mendimin pozitiv, Komisioni emërohet në takimin e përfaqësuesve të qeverive të shteteve anëtare në Këshillin Evropian, në të kundërtën nëse Parlamenti evropian jep mendim negativ e tërë proceduara nis nga fillimi.

Komisionin e udhëheq presidenti i ndihmuar nga disa zëvendës-presidentë. Përzgjedhjen e komisionerëve e bën presidenti i Komisionit. Komisionerëve u ndahen kompetencat në mënyrë që secili prej tyre të përgjigjet për një fushë të caktuar. Presidenti i Komisionit Evropian është edhe anëtar i Këshillit Evropian.

Komisionerët i kryejnë detyrimet në mënyrë të pavarur në interes të përbashkët të BE-së. Komisionerët nuk pranojnë dhe nuk kërkojnë sygjerime nga qeveritë dhe organet tjera, dhe shtetet obligohen të respektojnë pavarësinë e anëtarëve të Komisionit duke mos ushtruar ndikim ndaj tyre gjatë kryerjes së detyrave.

Çdo anëtar i Komisionit obligohet t'i përmbahet aktiviteteve që janë në pajtim me detyrat e tij, gjithashtu gjatë marrjes së detyrës bëjnë betimin solemn që gjatë mandatit do të respekton detyrimet për veprim të drejtë. Nëse nuk i respekton këto detyrime Komisioni kërkon nga Gjykata shkarkimin e komisionerit dhe i merret e drejta e pensionit.

Secili anëtar ka përgjegjësi për një apo më tepër fusha, mirëpo vendimet merren në bazë të përgjegjësive kolektive. Komisionerët marrin pjesë në mbledhjet e Parlamentit Evropian, me ç'rast u përgjigjen rregullisht pyetjeve, me gojë dhe me shkrim të deputeteve të Parlamentit evropian. Anëtarët e Komisionit kanë barriera mirëpo ata zakonisht janë ekspert të njohur të cilët ushtrojnë funksionin në mënyrë profesionale gjatë mandatit të tyre me të drejtë rizgjedhje. Përderisa Komisioni dhe anëtarët e tij kanë ndikim të madh në vendimmarrje, obligohen të evitojnë konfliktet dhe mosmarrëveshjet me interesat nacionale të shteteve anëtare.

Traktati i Lisbonës (neni 17) parasheh reduktimin e numrit të komisionerëve nga 27 (sa ishin në atë kohë) në dy të tretat e shteteve anëtare që prej vitit 2014, përveq nëse Këshilli evropian vendos ndryshe me unanimitet. Por, Këshilli ka vendosur që numri i komisionerëve të mbetet i njejtë me numrin e shteteve anëtare, pra aktualisht 28 komisionerë.

Traktati i Lisbonës bën edhe lidhjen direkte në mes të rezultatit të zgjedhjeve parlamentare Evropiane dhe zgjedhjes së kandidatit për President të Komisionit. Parlamenti ka një rol vendimtar në zgjedhjen e Presidentit të Komisionit i cili duhet të ketë përgjegjësi për reflektimin e rezultateve zgjedhore në politika konkrete dhe raportim në Parlamentin Evropian

Struktura organizative e Komisionit Evropian

Struktura organizative e Komisionit Evropian ndahet në dy pjesë: Departamentet e përgjithshme (DG) dhe shërbimet që gjithsejt janë 42.

Departamentet e përgjithshme (DG): janë përgjegjës për një resor dhe udhëhiqen nga Drejtorët që i japin përgjegjësi njërit nga komisionerët. Drejtoritë ndahen në sektor, çdo anëtar i Komisionit formon një kabinet prej ekspertëve, i kryesuar nga shefi i kabinetit. Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të Komisionit mbahen rregullisht mbledhje të shërbimeve të kabineteve.

Këto departamente përgatisin legjislacionin në fazën fillestare. Ato kanë në përbërje shumë ekspertë të fushave relevante dhe bëjnë analizat e duhura para se të inicohet një akt ligjor. Që të ketë efikasitet të veprimeve të Komisionit, Drejtorisë së Përgjithshme u kërkohet të bashkëpunojë dhe të kordinohet në përgaditjen dhe implementimin e akteve ligjore. DG-të sigurojnë vazhdimësi institucionale të punës së Komisionit.

Zyrat e shërbimeve: përfaqësojnë aspektin administrativ të Komisionit. Këto zyra ofrojnë shërbime ligjore të ekspertëve, të përkthimeve etj.

Organizimi i punës së Komisionit Evropian

Komisioni evropian ka organizimin e vet të punës, ku takohet një herë në javë në Bruksel; ai ka një numër të madh zyrash në Luksemburg, poashtu ka përfaqësi në të gjitha shtetet antëtare të BE-së si dhe delegacione në disa prej kryeqyteteve të botës.

Komisioni evropian planifikon dhe përcakton objektivat strategjike shumëvjeçare dhe strategjitë vjetore politike gjithashtu aprovon planin e punës dhe propozim/ buxhetin për vitin e ardhshëm. Komisioni i paraqet Parlamentit çdo vit për aprovim një raport financiar për mënyrën e shfrytëzimit të parave. Komisioni ka në dispozicion një buxhet të caktuar të cilat i shfrytëzon për programe të shumta, ndërsa një përqindje të vogël e shfrytëzon për çështje administrative. Në mbledhjen e Komisionit vendimet merren me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i komisionerëve ndërsa për t'u mbajtur mbledhja duhet të ketë kuorum. Koordinimi i tërësishëm i punëve në Komisionin Evropian bëhet nga Sekretariati i Përgjithshëm i Komisionit, i cili

menaxhon takimet javore të Komisionit, pëgjigjet përpara kryetarit, është i obliguar të drejtoj punimet përgaditore koordinuese, zbaton vendimet e Komisionit, dhe mbanë lidhje me institucionet tjera të BE-së. Një Drejtori e Përgjithshme, mund të përgadisë propozim/akt i cili mund të bëhet zyrtar kur të miratohet në takimin javor të Komisionit. Propozimi diskutohet me departamentet e Komisionit duke u kontrolluar nga shërbimet juridike dhe Sekretariati, në këtë mënyrë kur të jetë i gatshëm do të futet për diskutim në takimin e ardhshëm të Komisionit. Nëse nga 27 komisionerë, 14 prej tyre e aprovojnë propozimin, atëherë Komisioni ka shprehur përkrahjen e vet dhe dokumenti do t'i dorëzohet në shqyrtim Parlamentit dhe Këshillit.

Komisioni evropian drejtohet nga Presidenti i cili:

- Orienton punët e Komisionit
- Vendos për organizimin e brendshëm të Komisionit,
- Emëron zëvendëspresidentët dhe
- Ka të drejtë të shkarkojë anëtarët e Komisionit

Komisioni evropian ka katër role kryesore:

1. Të propozojë legjislacion në Parlament dhe në Këshill;
2. Të menaxhojë dhe implementojë politikat dhe buxhetin e BE-së;
3. Të zbatojë ligjin evropian (së bashku me Gjykatën e Drejtësisë);
4. Të përfaqësojë Bashkimin në mbarë botën.

Propozimi i legjislacionit të ri

Komisioni bartë të drejtën ekskluzive për iniciimin e propozimit të legjislacionit të Këshilli të ministrave dhe Parlamenti evropian. Këto propozime duhet të synojnë mbrojtjen e interesave të Bashkimit Evropian dhe qytetarëve të tij, dhe jo interesave të ngushta të ndonjërit shtet anëtar apo grup interesi. Në iniciues të një akti ligjor, Komisioni duhet të sigurohet që është institucioni të cilit i takon iniciimi i atij akti ligjor; duhet të vlerësojë se legjislacioni i BE-së është mënyra më e mirë për të trajtuar atë çështje dhe poashtu të konsiderojë rrethanat politike evropiane. Prandaj, Komisioni mban relacione të vazhdueshme me një numër të madh të grupeve të interesit dhe me dy organet këshilldhënëse — Komiteti Ekonomik dhe Social (i përbërë nga përfaqësues të punëdhënësve dhe sindikatës) dhe Komiteti i Rajoneve (i përbërë nga përfaqësues të autoriteteve lokale dhe rajonale). Komisioni harton një studim të rrethanave për çdo iniciim të legjislacionit dhe poashtu kërkon opinionet e parlamenteve nacionale, qeverive dhe publikut. Komisioni propozon legjislacion në nivel të BE-së, vetëm nëse mendon se një problem nuk mund të zgjidhet në legjislacionin nacional, rajonal dhe lokal. Parimi i trajtimit të çështjeve në nivelin më të ulët të mundshëm, quhet 'parimi i subsidiaritetit'. Nëse Komisioni vjen në përfundim se është i nevojshëm ai legjislacion në nivel të BE-së, atëherë

harton një propozim të cilit i beson se do të mund të zgjidh atë çështje në mënyrë efektive. Përfundimisht, legjislacioni në fjalë hartohet nga ekspertë që përbëjnë komitetet e Komisionit në konsultim edhe me grupet e interesit.

Implementimi i politikave të BE-së dhe buxheti

Njëri nga misionet kryesore të Komisionit Evropian është menaxhimi dhe implementimi i buxhetit të BE-së dhe të politikave dhe programeve të miratuara nga Parlamenti dhe Këshilli. Mënyra e shpenzimit të buxhetit kontrollohet nga Gjykata e Auditorëve përmes raportit vjetor të auditimit. Parlamenti evropian pranon raportin vjetor të Gjykatës së auditorëve dhe e miraton atë përpara se të jep dritën e gjelbër për të implementuar buxhetin e vitit të ardhshëm.

Zbatimi i ligjit evropian

Së bashku me Gjykatën e Drejtësisë, Komisioni siguron zbatimin e ligjit të BE-së në të gjitha shtetet anëtare duke u bërë kështu 'gardian i së drejtës evropiane'. Komisioni është përgjegjës poashtu për implementimin e programeve dhe politikave të përbashkëta të BE-së, përcakton rregullat për realizimin e dispozitave të traktateve të BE-së si dhe realizimin e mjeteve buxhetore të cilat janë të përcaktuara për aktivitetet e BE-së. Në rast të mos respektimit ose të mos zbatimit të legjislacionit ose vendimeve të Bashkimit Evropian nga shtetet anëtare, Komisioni ndërmerr hapat e duhur, ashtu sic e parasheh Traktati ne fuqi. Komisioni fillon një proces ligjor të quajtur 'procedura e shkeljes', në të cilin përfshihet letra zyrtare që i dërgohet qeverisë të shtetit anëtar, ku sqarohet pse Komisioni beson që ky vend e shkel ligjin e BE-së dhe i cakton një afat për t'i dërguar Komisionit një përgjigje të hollësishme. Në rast se sqarimi nuk mjafton për Komisionin evropian, atëherë Komisioni e dërgon çështjen në Gjykatën e Drejtësisë, e cila ka fuqinë që të marrë vendimin e duhur. Gjykata ka të drejtë të marrë vendime të formës së prerë për të gjitha shtetet anëtare e që mund të jenë detyruese si për shtetet ashtu edhe për institucionet e BE-së

Përfaqësimi i BE-së në arenën ndërkombëtare

Përfaqësuesi i Lartë për Punë të Jashtme dhe të Sigurisë është njëkohësisht Zëvendës-presidenti i Komisionit Evropian dhe është përgjegjës për çështjet e jashtme dhe çështjet e sigurisë së përbashkët. Çështjet që kanë të bëjnë me punët e jashtme dhe sigurinë mbasin përgjegjesi ekskluzive të Këshillit, por që ka kordinim për atë sa Komisioni ka kompetenca. Komisioni mban përgjegjësi më të mëdha sa i përket tregtisë së jashtme dhe ndihmës së jashtme humanitare. Komisioni ka kompetenca të lidhë marrëveshje me shtetet e treta dhe të negociojë, gjithashtu lidhë raporte me organizata ndërkombëtare. Këtë më së miri e dëshmojnë marrëveshjet e shumta të lidhura me vendet e treta ose grupe shtetesh të cilat janë të ndihmuara nga Komisioni. Komisioni evropian vepron si një zëdhënës i Bashkimit Evropian në skenën ndërkombëtare, kryesisht për çështje ekonomike e tregtare si psh në Organizatën Botërore të Tregtisë. Që nga viti 1992 është themeluar Departamenti i Ndhmës Humanitare dhe Mbrojtjes Civile i Komisionit Evropian (ECHO), i cili përmes aktiviteteve humanitare, përbëjnë pozitën kryesore të aktiviteteve të jashtme të Bashkimit Evropian. Rreth 150 milionë njerëz marrin ndihmë me anë të ndihmave humanitare të BE-së. Kjo ndihmë ndahet përmes 200 partnerëve, siç janë organizatat bamirëse dhe agjencitë e Kombeve të Bashkuara.

2.5 Banka Qendrore Evropiane

Roli:	Institucion mbi-kombëtar, përgjegjës për politikat montare
Përbërja:	Bankat qendrore nacionale të euro zonës
Selia:	Frankfurt



16. Ndërtesa e Bankës evropiane

Banka qendrore evropiane (BQE) është themeluar në vitin 1998 me marrëveshjen e Bashkimit Evropian që të strukturoj dhe implementoj politikat monetare dhe ekonomike të BE-së, për të promovuar valutën e re evropiane, menaxhimin e këmbimeve të jashtme si dhe funksionimin e sistemit të pagesave. BQE-ja me seli është e vendosur në Frankfurt.

Qëllimet kryesore të Bankës Qëndrore Evropiane janë:

- a) Ruajtja e stabilitetit të çmimeve në Eurozonë, njëkohësisht duke mbajtur nën kontrollë inflacionin dhe rritjen e çmimeve të konsumit. Ky qëllim realizohet duke kontrolluar qarkullimin e parasë në treg dhe mbikqyrjen e trendeve të çmimeve. Në bazë të qarkullimit të parasë në treg Banka përcakton normën e kamatës.
- b) Stabiliteti i sistemit financiar duke marrë parasysh mbikqyrjen në nivelin e duhur të tregjeve financiare dhe institucioneve tjera.

Funksionet kryesore të Bankës Qëndrore janë:


- a) Mbikqyrja dhe kontrollimi i parasë në qarkullim si dhe përcaktimi i normës së kamatës në Eurozonë
- b) Mbajtja e normës së këmbimit të valutave në nivel të duhur përmes menaxhimit të rezervave të valutave të jashtme (shitblerja e valutave)
- c) Autorizon Bankat Qendrore të shteteve anëtare të Eurozonës për të emetuar para (valutën Euro)



Në grupin e detyrave tjera të Bankës evropiane mund t'i rradhisim edhe këto detyra: formulimin dhe implementimin e politikës monetare të BE-së, përmirësimin dhe funksionimin pa pagesë të sistemeve pagesore, ushtrimin e operacioneve devizore, kontribut në realizimin efikas të politikës nga institucionet nacionale.

Banka Qendrore është e përbërë nga:

- a) Bordi ekzekutiv – është përgjegjës për implementimin e politikave monetare dhe dhënien e instruksioneve Bankave Qëndrore të shteteve të Eurozonës
- b) Këshilli Drejtues (Qeverisës) është organi më i lartë vendimmarrës i BQE-së. Udhëhiqet nga Presidenti i BQE-së, anëtarët e Bordit Ekzekutiv dhe Guvernatorët e Bankave Qendrore të Eurozonës. Këshilli qeverisës cakton normat e kamatës që Bankat Komerciale mund të marrin para nga BQE-ja.
- c) Këshilli i përgjithshëm është organi i tretë vendimmarrës i cili përbëhet nga: Presidenti, Zëvendës-presidenti, si dhe Guvernatorët e Bankave Qendrore të të gjitha vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Ky Këshill kryen aktivitete këshilldhënëse si dhe aktivitete tjera në lidhje me zgjerimin e mëtejshëm të Eurozonës.



17. Rapoti i Bankës Qendrore Evropiane me bankat kombëtare

BQE-ja më shumë rëndësi i kushton stabilitetit të çmimeve dhe shumë pak rëndësi aspekteve tjera ekonomike.

2.6 Banka Evropiane e Investimeve

Roli: Institucion mbiqeveritar përgjegjes për investime

Selia: Luksemburg

Banka Evropiane e Investimeve është agjenci financiare e formuar në vitin 1958 me Traktatin e Romës, qëllimi i së cilës është 'zhvillimi i balancuar dhe stabil' i BE-së. Banka Evropiane e Investimeve mundëson kredi dhe garanca në të gjithë sektorët ekonomikë, sidomos në inkurajimin e zhvillimit të rajoneve më pak të zhvilluara dhe mbështetjen e projekteve me interes të përbashkët për disa shtete anëtare.

Ajo u jep kredi afatgjate sektorëve publik dhe privat për projekte të cilat kanë të bëjnë me:

- a) përkrahjen për ndërtimin e infrastruktures, komunikacionit dhe telekomunikacionit.
- b) duke ngritur konkurrencën ndërkombëtare të industrisë evropiane,
- c) duke siguruar furnizimin me energji elektrike,
- d) duke i përkrahur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme,
- e) mbrojtjen e mjedisit jetësor
- f) përmirësimin e shëndetit dhe arsimimit.





17. Raporti i Bankës Qendrore Evropiane me bankat kombëtare

Detyrë kryesore e kësaj banke është që të zhvillojë tregun e përbashkët në interes të BE-së duke shfrytëzuar fondet e veta dhe fonde të tregut kapital. Për këtë arsye Banka ndihmon duke dhënë kredi dhe garanci në bazë jofitimprurëse.

Banka Evropiane e investimeve është një institucion jofitimprurës dhe i pavarur i BE-së, që dallon nga Banka Qendrore Evropiane, pasi merr para nga tregjet e kapitalit dhe i jep ato në formë të huasë.

Banka bashkëpunon me institucionet e BE-së për realizimin e objektivave të përbashkëta të shteteve anëtare.

Vendimet e Bankës merren nga:

- a) Bordi i Drejtorëve - kryesohet nga Drejtori i Bankës dhe nga një anëtar i secilit shtet si dhe një anëtar nga Komisioni evropian. Aprovon operacionet huazuese dhe realizon vendimet e Bordit të Guvernatorëve.
- b) Këshilli menaxhues – përbëhet nga ekzekutivi i Bankës dhe kryen aktivitete ditore.

2.7 Gjykata e drejtësisë së Bashkimit Evropian

Themeluar: 1952

Roli: Institucion mbi-kombëtar përgjegjës për interpretimin dhe vendimmarrjen për të drejtën evropiane

Përbërja: Gjykata e Drejtësisë: 1 gjyqtar nga çdo vend I BE-së, plus 11 avokatë të përgjithshëm

Gjykata e Përgjithshme: 47 gjyqtarë. Në 2019 kjo do të rritet në 56 (2 gjyqtarë nga çdo vend I BE).

Selia: Bruksel



19. Ndërtesa e Gjykatës së drejtësisë

Gjykata është krijuar në vitin 1952, me seli në Luksemburg. Funkzioni i saj kryesor është të siguroj që legjislacioni i BE-së të jetë i interpretuar dhe të aplikohet në të njëjtën mënyrë në çdo vend anëtar. Gjykata e kontrollon ligjshmërinë e veprimeve të institucioneve të BE-së, siguron Shtetet anëtare në përputhje me detyrimet e tyre dhe e interpreton ligjin e BE-së me kërkesë të gjykatave nacionale.

Ky institucion është i përfaqësuar nga një gjyqtar nga çdo vend i Bashkimit Evropian dhe nga nëntë avokatë të përgjithshëm të BE, -cilët shërbejnë si ndihmës. Në këtë mënyrë arrihet përfaqësimi i të gjitha sistemeve gjyqësore të vendeve të BE-së. Kjo Gjykatë merr vendime për mosmarrëveshjet ligjore midis shteteve anëtare, institucioneve të BE-së, bizneseve dhe individëve.



20. Përbërja e Gjykatës evropiane të drejtësisë

Gjykata e Drejtësisë përbëhet nga 28 gjyqtarë, një nga secili Shtet anëtar, në mënyrë që të gjitha sistemet ligjore kombëtare të BE-së janë të përfaqësuara. Në Gjykatë asistohen nëntë "Avokatët e Përgjithshëm" të cilët paraqesin mendimet e arsyetuara mbi rastet e ngritura para Gjykatës. Ata duhet ta bëjnë këtë publikisht dhe në mënyrë të paanshme. Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm janë ose ish-anëtarë të gjykatave më të larta kombëtare ose avokatë shumë kompetentë të cilët mund të mbështeten në të për të treguar paanësi.

Ata emërohen me marrëveshje të përbashkët të qeverive të shteteve anëtare. Mandati i gjykatësve zgjat për një periudhë prej 6 vjetëve. Për çdo tri vjet bëhet rizgjedhje e gjysmës nga përbërja e gjykatësve dhe nuk ka kufuzim për rizgjedhje. Çdo gjykatës para marrjes së kompetencave obligohet që ta bëjë betimin publikisht se do të ushtroj funksionin në mënyrë objektive dhe të ruaj sekretin e të dhënave nga fushëveprimi i tij.

Gjykata e Drejtësisë është e përbërë nga Dhoma e madhe e Gjykatës së Drejtësisë që zë 13 gjyqtarë (në një Gjykatë të plotë), ose dhomave të pesë ose tre gjyqtarëve, në varësi të kompleksitetit dhe rëndësisë së çështjes. Mbi 60% e rasteve janë dëgjuar nga dhomat me pesë gjyqtarë dhe rreth 25% nga ana e dhomave të tre gjyqtarëve.

Gjykata e Përgjithshme përbëhet prej 28 gjyqtarëve (secili shtet anëtar nga një gjyqtar), të emëruar nga shtetet anëtare për një mandat 6-vjeçar. Gjyqtarët e Gjykatës së Përgjithshme zgjedhin një president midis tyre për një periudhë 3-vjeçare. Dy Gjykatat mbledhet në Dhomat me tre ose pesë gjyqtarë (nganjëherë një gjyqtar i vetëm) për të mbajtur seanca. Rreth 80% e rasteve të Gjykatës së Përgjithshme janë dëgjuar nga tre gjykatës. Dhoma e Madhe me 13 gjyqtarë, ose Dhoma e plotë e 28 anëtarëve (gjyqtarëve), mund të takohen, nëse rasti i paraqitur është kompleks dhe i rëndë për t'u zgjidhur.



Rastet që kanë të bëjnë me gjykatën e Drejtësisë paraqiten në Zyrën e regjistrimit në Gjykatë (një gjykatës i veçantë) dhe Avokatit të Përgjithshëm. Pas raportimit të rastit, së pari është faza e të shkruarit pastaj kalon në marrjen në pyetje ose prezantimit gojor. Në fazën e parë me shkrim të gjitha palët e përfshira në rastin e paraqitur japin deklarata me shkrim. Gjykatësi i rastit përpilon një raport që përmbledh këto deklarata dhe bazën ligjore për këtë rast. Raporti diskutohet në Asamblenë e Përgjithshme të Gjykatës e cila vendos formimin gjyqësor që do të dëgjojë rastin (Asambleja e Përgjithshme e vendos se a ka nevojë që palët të dëgjohen edhe gojarisht). Pastaj vjen faza e dytë – dëgjimi publik – ku juristët vënë rastin e tyre para gjyqtarëve dhe Avokatit të Përgjithshëm.

Avokati i Përgjithshëm i caktuar për këtë rast përpilon mendimin e tij. Gjykatësi harton një projekt-vendim i cili i dorëzohet gjyqtarëve të tjerë për shqyrtim. Gjyqtarët pastaj japin gjykimin e tyre. Vendimet e Gjykatës janë të vendosura nga një shumicë e theksuar në një seancë publike. Në shumicën e rasteve teksti është në dispozicion në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së në të njëjtën ditë. Por, jo në të gjitha rastet aplikohet kjo procedurë standarde. Kur urgjenca e një çështjeje dikton, ekzistojnë procedurat e thjeshta dhe të përsheptuara, të cilat lejojnë që gjykata të vendosë brenda 3 muajve.

Llojet më të zakonshme të rasteve që shqyrtohen janë:

Gjykimet Paraprake

Gjykatat në çdo shtet anëtar të BE-së janë përgjegjëse për të siguruar që ligji i BE-së është aplikuar si duhet në atë vend. Nëse një gjykatë kombëtare është në ndonjë dyshim në lidhje me interpretimin ose vlefshmërinë e një ligji të BE-së ai mundet, dhe ndonjëherë duhet, të kërkojë nga Gjykata e Drejtësisë për këshilla. Kjo këshillë jepet në formën e detyrueshme të 'vendimit paraprak'. Ky vendim është një kanal i rëndësishëm për qytetarët, në gjykatat e tyre kombëtare, për të vendosur se sa ligjet e BE-së të ndikojnë mbi ta.

Gjykimet ndaj shkeljeve

Komisioni, ose (në disa raste të rralla), një Shtet anëtar, mund të fillojë këto procedura, në qoftë se ka arsye të besoj që një shtet anëtar ka dështuar për të përmbushur obligimet e veta sipas ligjit të BE-së. Gjykata heton pohimet dhe jep vendimin e saj. Nëse është gjetur të jetë në faj, shteti anëtar i akuzuar duhet të marrë masat e duhura, pa vonesë për të shmangur gjrobat që gjykata mund të aplikojë.

Procedura për anulimin e Akteve

Nëse ndonjë prej shteteve anëtare, Këshilli, Komisioni apo (nën kushte të caktuara) parlamenti, beson se një ligj i veçantë i BE-së është i paligjshëm, ata mund të kërkojnë nga Gjykata ta anulojë atë. Këto "procedura për anulim" mund të përdoren edhe nga individ privatë të cilët dëshirojnë nga gjykata shfuqizimin e një ligji të veçantë, sepse ai ndikon në ata drejtpërdrejt dhe negativisht.

Procedura për dështim për të vepruar

Traktati kërkon nga Parlamenti evropian, Këshilli dhe Komisioni për të marrë vendime të caktuara në rrethana të caktuara. Nëse ata nuk e bëjnë këtë, shtetet anëtare, institucionet e tjera të BE-së dhe (nën kushte të caktuara), individët apo kompanitë mund të paraqesin një ankesë pranë gjykatës në mënyrë që të ketë këtë shkelje të regjistruar zyrtarisht.

2.8 Gjykata Evropiane e Auditorëve

Roli: Kontrollimi i shpenzimeve/fondet të BE-së. Raportet e kësaj Gjykate ndihmojnë në përmirësimin e menaxhimit financiar të BE-së.

Anëtarët: 1 nga çdo vend I BE-së

Vendndodhja: Luksemburg



21. Ndërtesa e Gjykatës evropiane të auditorëve

Gjykata Evropiane e Auditorëve kujdeset për interesat e taksapaguesve të BE-së duke kontrolluar menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit të BE-së. Më konkretisht, kjo Gjykatë është institucion që bën auditimin e financave publike të Bashkimit Evropian duke përfshirë buxhetin, të hyrat, shpenzimet, projektet, investime brenda zonës dhe jashtë saj si dhe programet që kanë të bëjnë me hapjen e vendeve të reja të punës brenda zonës evropiane dhe krijimin e klimës me të favorshme për investimet e jashtme në BE.

Ajo kontrollon çdo person apo organizatë që menaxhon fondet e BE-së - duke përfshirë kontrollat në institucionet e BE-së (veçanërisht Komisionin), shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet që marrin ndihmë nga BE.

Gjykata e auditimit ka këto funksione:

- Ajo nxjerr Raporte të auditimit me gjetjet e saj për Komisionin Evropian dhe qeveritë kombëtare.
- Raporton mashtrime të dyshuara, korrupsion ose veprimtari të tjera të paligjshme në Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit.
- Harton një raport vjetor për Parlamentin Evropian dhe Këshillin e BE-së, të cilin Parlamenti shqyrton përpara se të vendosë nëse do të miratojë buxhetin vjetor të BE të paraqitur nga Komisioni.
- Jep mendimin e saj (të ekspertëve) tek politikëbërësit e BE-së se si financat e BE-së mund të menaxhohen më mirë dhe të bëhen më të përgjegjshme për qytetarët.
- Gjithashtu publikon mendime mbi legjislacionin përgatitor që do të ndikojë në menaxhimin financiar të BE-së, si dhe dokumentet e pozicionit, rishikimet dhe publikimet ad hoc mbi çështjet e financave publike të BE-së.

Këshilli i Gjykatësve është i përbërë nga 28 gjykatës të dërguar nga secili shtet anëtar i Bashkimit Evropian. Anëtarët e gjykatës emërohen nga Këshilli, pas konsultimit me Parlamentin, për mandate të rinovueshme 6-vjeçare. Ata zgjedhin Presidentin për një mandat 3-vjeçar.

Janë mëse 800 punonjës të kualifikuar (duke përfshirë auditorët dhe përkthyesit), që përgatisin draft raporte për të cilat gjykata merr vendime. Ata i përgatisin raportet në grupe të auditimit, që i përfaqësojnë 'dhomat'.

Kjo Gjykatë kryen tri lloje të auditimit:

- Auditimet financiare - duke kontrolluar që llogaritë me saktësi paraqesin pozicionin financiar, rezultatet dhe rrjedhën e parasë për vitin.
- Auditimet e pajtueshmërisë – kontrollon, nëse për transaksionet financiare janë ndjekur rregullat e parapara.
- Auditimet e performancës - duke kontrolluar që fondet e BE-së kanë arritur qëllimet e tyre me burimet më pak të mundshme dhe në mënyrën më ekonomike.

Rezultatet dhe puna e GJEA-së shfrytëzohen nga Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian, Këshilli si dhe shtetet anëtare për të parë menaxhimin e buxhetit evropian dhe aty ku mundet edhe të ndërhyhet me qëllim të rritjes së cilësisë.

2.9 Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social

Roli: Të përfaqësojë interesin e shoqërisë civile

Anëtarët: 353 nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së

Vendndodhja: Bruksel



European Economic and Social Committee

Qëllimi i Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social (EESC) është të mundësojë përfaqësimin në ndonjë institucion të BE-së për grupet e ndryshme ekonomike dhe sociale (sidomos punëdhënësit dhe punëtorët, bujqit, transportuesit, afaristët, zanatçinjtë, menaxhuesit e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme). Komiteti gjithashtu ofron mundësi për konsumatorët, grupet dhe asociacionet e ambientit jetësor. Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social përbëhet nga maksimum 353 anëtarë (këshilltarë), nga organizatat më reprezentative në Shtetet anëtare individuale. Ata emërohen për pesë vjet nga Këshilli, i cili, njëzëshëm miraton listën e anëtarëve të zgjedhur, në pajtim me propozimet e çdo Shteti Anëtar.

Anëtarët janë të ndarë në tri grupe (punëdhënës, punëtorë dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile). Opinionet që duhet të miratohen në seancat plenare, hartohen nga 'grupet studiuese' të cilat përbëhen nga anëtarët e EESC-së. EESC-ja gjithashtu punon ngushtë me komitetet e Parlamentit Evropian.

EESC-ja, e cila u themelua nën Traktatet e Romës, në rrethana të caktuara duhet të konsultohet me Këshillin, i cili vepron pas propozimit të Komisionit. Ai gjithashtu jep opinione me iniciativën e vet. Këto opinione përfaqësojnë një sintezë të qëndrimeve ndonjëherë shumë divergjente dhe janë jashtëzakonisht të dobishme për Komisionin dhe Këshillin pasi që ato tregojnë se cilat ndryshime duan t'i shohin grupet që janë drejtpërsëdrejti të prekura nga një propozim. Opinionet me iniciativë personale të EESC-së, në shumë raste kanë pasur implikime të mëdha politike, dhe një nga këta shembuj është ai më 22 shkurt 1989, mbi të drejtat themelore sociale në BE, të cilat përbënin bazën për "Kartën Sociale" të propozuar nga Komisioni.

2.10 Komiteti i Rajoneve

Roli: Të përfaqësojë interesin e qyteteve apo rajoneve të BE-së

Anëtarët: 353 nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së

Vendndodhja: Bruksel



European Committee of the Regions

Me Traktatin e Bashkimit Evropian (Traktati i Mاستrihtit) u themelua edhe një organ i ri këshilldhënës: Komiteti i Rajoneve (CoR). Ashtu si edhe EESC-ja, Komiteti i Rajoneve nuk është institucion krejtësisht i BE-së, pasi që funksioni i tij është vetëm këshilldhënës dhe nuk ka fuqi të japë vendime detyruese me ligj, në mënyrën e njëjtë si institucionet me të drejta të plota (Parlamenti evropian, Këshilli, Komisioni evropian, Gjykata e Drejtësisë, Gjykata e Revizorëve, Banka Qendrore Evropiane).

Ashtu si EESC-ja, Komiteti i Rajoneve përbëhet nga maksimum 353 anëtarë. Anëtarët janë përfaqësues të autoriteteve rajonale dhe lokale në shtetet anëtare, të cilët duhet doemos të kenë mandat në bazë të zgjedhjeve nga autoritetet që ata i përfaqësojnë, ose duhet që të jenë politikisht të BEsueshëm për ta. 353 ulëset u janë ndarë shteteve anëtare me përdorimin e peshës së njëjtë si për Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social. Anëtarët emërohen për pesë vjet nga Këshilli, i cili, duke vepruar njëzëshëm, miraton listën e anëtarëve, të hartuar në pajtim me propozimet e të gjitha shteteve anëtare. Anëtarët e Komitetit zgjedhin, nga vetë numri i tyre, kryesuesin me mandat dy vjeçar

Ekziston një numër i çështjeve për të cilat nevojitet konsultimi me Këshillin e BE-së ose me Komisionin Evropian: arsimi; kultura; shëndeti publik; rrjetet trans-evropiane; transporti, telekomunikacioni dhe infrastruktura energjetike; kohezioni ekonomik dhe social; politika e punësimit dhe legjislacioni social. Këshilli gjithashtu konsultohet me Komitetin rregullisht, dhe pa ndonjë obligim ligjor, në lidhje me një numër të madh të propozim legjislativëve.



3

3. Vendimmarrja në Bashkimin Evropian

Vendimmarrja në BE zhvillohet në shumë nivele, por dy janë nivelet kryesore: mbikombëtar dhe ndërqeveritar.

Të dyja këto nivele janë përcaktuar gjatë thellimit të integritit të BE-së dhe nënshkrimin e traktateve. Shtetet anëtare, si rezultat i anëtarësimit të tyre në BE kanë deleguar kompetencat e tyre në institucionet e BE për fusha të caktuara, që kryesisht kane të bëjnë me ekonominë. Kështu, institucionet e BE-së janë fuqizuar për të marrë vendime të detyrueshme mbikombëtare përmes procedurave të tyre legislative dhe ekzekutive, procedurave buxhetore, procedurave të emërimit dhe procedurave gati-kushtetuese. Këtë nivel e përfaqësojnë institucionet e zgjedhura dhe psh: Parlamenti Evropian

Kurse niveli ndërqeveritar në Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, si dhe në disa fusha të tjera të tilla si bashkëpunimi i përmirësuar, emërimet e caktuara dhe rishikimi i traktateve, procedura e vendimmarrjes është e ndryshme nga ajo që mbizotëron në procedurën e zakonshme legislative. Tipari dominues në këto fusha është një komponent i fortë i bashkëpunimit ndërqeveritar. Sfida e krizës së borxhit publik ka provokuar një përdorim më të madh të mekanizmave të tilla vendimmarrës, veçanërisht në kuadrin e qeverisjes ekonomike evropiane.

Mënyra e marrjes së vendimeve në BE është e përcaktuar me Traktatin e Lisbonës dhe traktatet e tjera në fuqi. Traktatet specifikisht definojnë mënyrën e vendim-marrjes për nxjerrjen e legjislacionit në fusha të caktuara në bazë të kompetencave të secilit institucion në vendim-marrje.

Por, përshkruajnë poashtu rrugën e vijimit të një ligji që nga iniciimi nga Komisioni evropian, leximet që duhet të bëjë Parlamenti evropian dhe Këshilli si dhe opinionet nga institucionet këshilluese e deri te institucioni final vendimmarrës.

Traktati i Lisbonës ka paraparë tri procedura të nxjerrjes së akteve ligjore:

- Procedura e bashkëvendim-marrjes (e zakonshme legislative)
- Procedura e konsultimi (specifike)
- Procedura e pëlqimit (specifike)

3.1 Procedura e bashkëvendim-marrjes (e zakonshme legislative)

Krijuar nga Traktati i Mastrohtit (1992), procedura e vendimmarrjes së përbashkët mundëson miratimin nga Këshilli i Ministrave dhe Parlamentit Evropian, e një propozimi legjislativ. Traktati i Lisbonës ka dyfishuar numrin e fushave në të cilat aplikohet procedura e vendimmarrjes së përbashkët, poashtu ka shtuar fusha të ndjeshme të politikës së përbashkët bujqësore ose politikat relative të kontrollit të kufijve, azilit dhe emigracionit.

Pjesa më e madhe e legjislacionit të Bashkimit Evropian miratohet duke aplikuar 'procedurën e zakonshme legislative

Procedura fillon me Komisionin evropian, i cili bën iniciimin e legjislacionit. Komisioni zhvillon një konsultim paraprak me qeveritë e shteteve anëtare, shoqëri të civilë, bizneset, grupet e interesit, eventualisht individë të caktuar. Parlamentet e shteteve anëtare por edhe Komuniteti Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komiteti i Rajoneve deklarojnë opinionet e tyre zyrtare rreth këtij akti ligjor. Ka raste kur institucionet e BE-së si Këshilli evropian, Këshilli, Parlamenti por edhe qytetarët e BE-së paraqesin kërkesën te Komisioni evropian për hartim/propozim të një ligji të vecantë, të cilin zyrtarisht e paraqet për aprovimi Komisioni evropian.

Syqyerimet nga këto grupe përfshihen në propozimin që bën Komisioni evropian dhe ligji i përcillet Parlamentit dhe Këshillit në të njëjtën kohë për shqyrtim. Të dyja këto institucione në bazë të procedurave të veta institucionale shqyrojnë ligjin e propozuar.

Nëse akti ligjor kalon në lexim të parë të shqyrtuar ndaras në Këshill dhe Parlament atëherë ligji aprovohet. Nëse në leximin e dytë nuk arrijnë të miratojnë ligjin në fjalë atëherë thirret Komiteti për pajtim, i cili e konsolidon një tekst të pajtueshëm për Parlamentin dhe Këshillin.

Ky draft kalon për miratim në Këshill dhe Parlament, por në rast që nuk arrin të aprovohet atëherë ligji nuk miratohet.

3.2 Procedura e konsultimit


Në procedurën e konsultimit (ose opinionit të thjeshtë), Parlamenti evropian jep opinionin e vet mbi një propozim legjislativ i cili do të miratohet me pas nga Këshilli. Kjo procedurë zbatohet aktualisht në një numër të reduktuar të fushave legjislative, si përjashtimet nga tregun e brendshëm, ligjin e konkurrencës, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare, si pjesë e CFSP-së.

Kjo procedurë zbatohet në disa fusha të tilla si bujqësia, rregullat e konkurrencës, çështjet fiskale dhe rishikimin e traktateve.

3.3 Procedura e pëlqimit

Kjo procedurë është paraparë me Aktin Unik Evropian (1986), me të cilën kërkohet që Këshilli evropian të ketë marrëveshje me Parlamentin Evropian paraprakisht për çështje dhe vendime të rëndësishme. Parlamenti evropian mund të pranojë ose të refuzojë propozimin e Këshillit, por nuk mund të ndryshojë atë. Kjo procedurë është veçanërisht e zbatueshme në lidhje me traktatet e antarësimit, marrëveshjet e asociimit ose marrëveshjeve të tjera me vendet e treta.

Kjo procedurë përdoret edhe gjatë miratimit të masave të reja legjislative kundër diskriminimit dhe tani i jep Parlamentit Evropian të drejtën e vetos në rast të aplikimit të bazës së përgjithshme nënligjore në bazë të nenit 352 të Traktatit mbi funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU).



The image features a white background with decorative geometric elements. In the top-left corner, there is a dark blue shape and a yellow triangle with fine parallel lines. In the bottom-right corner, there is a dark blue triangle, a yellow triangle with fine parallel lines, and a green triangle with fine parallel lines. Centered on the page is a large number '4' filled with fine parallel lines.

4

4. Rendi ligjor i BE-së

Bashkimi Evropian ka personalitet juridik dhe si i tillë ka rendin e tij ligjor, i cili është i veçantë në të drejtën ndërkombëtare. Për më tepër, e drejta e BE-së ka efekt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në ligjet e shteteve anëtare dhe bëhet pjesë e sistemit ligjor të secilit shtet anëtar. Bashkimi Evropian është në vetvete një burim i së drejtës. Rendi ligjor i BE-së ndahet në burimet/legjislacionin primar (Traktatet dhe parimet e përgjithshme ligjore), burimet/legjislacionin dytësor (bazuar në Traktatet) dhe të drejtën suplementare.

4.1 Burimet primare

Burimi i parë i të drejtës evropiane janë Traktatet themeluese të BE-së, me shtojcat e ndryshme dhe protokolet e bashkangjitura, si dhe plotësimet dhe ndryshimet e mëvonshme. Këto Traktate themeluese dhe instrumentet që i ndryshojnë apo i plotësojnë ato (kryesisht Traktatet e Mاستrihtit, Amsterdimit, Nicës dhe Lisbonës) dhe Traktatet e ndryshme për Anëtarësim përmbajnë dispozitat themelore mbi objektivat e BE-së, organizimin e tij dhe mënyrën e funksionimit, si dhe pjesë të të drejtës ekonomike të BE-së. Këto përbëjnë kornizën themeluese për funksionimin e BE-së, e pastaj reflektohen në interesat e Bashkimit, me anë të aktivitetetve legjislative dhe administrative nga institucionet e Bashkimit. Traktatet, duke qënë instrumente ligjore të krijuara në mënyrë direkte nga shtetet anëtare, që në gjuhën ligjore njihet si e drejtë primare e Bashkimit Evropian.

Aktet ligjore që kanë ndikim direkt te shtetet antare janë rregulloret. Rregulloret jane i vetmi burim dytësor ligjor i BE-së që ka zbatueshmëri obligative në tërësi për të gjitha shtetet anëtare. Ajo duhet të gjejë zbatim menjeherë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të BE-së. Rregulloret dallohen me dy karakteristika specifike në të drejtën ndërkombëtare.

- E para është natyra e tyre unike, që do të thotë se ato përcaktojnë rregullin e njëjtë në mbarë BE-në, pa marrë parasysh kufijtë ndërkombëtar dhe kanë zbatim të plotë në të gjitha shtetet anëtare. Një shtet anëtar nuk ka fuqi të zbatojë një rregullore vetëm pjesërisht ose të zgjedhë vetëm ato dispozita, të cilat i miraton si mjet që garanton se një instrument të cilin e ka kundërshtuar në kohën e miratimit ose i cili vepron kundër interesave nacionale nuk ka hyrë në fuqi.

- E dyta është zbatueshmëria direkte, që do të thotë se rregulloret e BE-së nuk duhet të kalojnë në ligj nacional apo të adaptohen. Shtetet anëtare, institucionet e tyre qeverisëse dhe gjykatat detyrohen drejtpërsëdrejti nga e drejta e Bashkimit dhe duhet të pajtohen me të njëjloj si me të drejtën nacionale.

4.2 Burimet sekondare të BE-së

Me themelimin e BE-së janë themeluar institucione të cilat miratojnë akte juridike të njohura si burime sekondare të legjislacionit të BE-së. Legjislacioni i BE-së përcakton tre lloje aktesh juridike të obligueshme siç janë: urdhëresa, direktiva dhe vendimet dhe dy lloje të akteve jo të obligueshme: rekomandime dhe opinione. Përmes këtyre akteve juridike pasqyrohet legjislacioni sekondar i BE-së, i cili miratohet më qëllim që ti realizoj politikat të cilat janë përcaktuar në traktatet themeluese të BE-së dhe KE-ve.

a. Urdhëresat

Urdhëresat janë akte më të rëndësishme juridike të cilat miratohen nga institucionet e BE-së. Ato kanë fuqi detyruese të zbatueshme në tërë territorin e BE-së, të obligueshme për të gjitha shtetet anëtare, personat fizik dhe juridik. Pas hyrjes në fuqi urdhëresat bëhen pjesë e legjislacionit nacional të shteteve anëtare pa nevojë për implementimin e tyre. Gjykata e Drejtësisë është ajo e cila bënë dallimin midis të ashtuquajturave “urdhëresa themelore” të cilat kanë të bëjnë me rregullat themelore, menaxhimin dhe harmonizimin në fusha të ndryshme, të cilat i miraton Këshilli. Përderisa “urdhëresat ekzekutive” teknikisht i organizojnë këto ndryshime. Përderisa urdhëresat janë të obligueshme të zbatohen në çdo shtet anëtar ato duhen të përshtaten në mënyrë që të përfshihen në një sistem juridik të atij shteti. Dispozitat në urdhëresa duhet të jenë të qarta dhe nuk varen nga ndërmarrja e masave nga ana e Bashkimit Evropian dhe Autoriteteve Nacionale.

a. Direktivat

Ministrat e Qeverive të shteteve anëtare miratojnë direktiva në Këshillin Evropian dhe Parlamentin Evropian.

Direktivat janë akte individuale juridike dhe janë të obligueshme sa i përket qëllimeve dhe rezultateve që duhet të arrihen, kurse realizimi i saj iu është lënë në dorë autoriteteve kompetente të shtetit që i është adresuar kjo direktivë. Direktivat për dallim nga urdhëresat duhet të implementohen në legjislacionin nacional të shteteve anëtare. Për veprim të drejtëpërdrejtë tek direktivat mungojnë elementet themelore, që të kenë efekt të drejtëpërdrejtë është i nevojshëm implementimi i tyre. Në rastet kur shtetet ose nuk arrijnë ose nuk shprehin vullnet për të implementuar drejtë direktivat, proceset integruese kanë efekt negative. Në këto raste Komisioni evropian mund të iniciojë procedurë juridike kundër këtij shteti. Inicimi i procedurave juridike bëhet në Gjykatën Evropiane të drejtësisë e cila tenton që të promovojë efikasitetin juridik të direktivave edhe në mungesë të implementimit juridik. Direktivat kanë efekt direkt atëherë kur implementohen në legjislacionin e shtetit përkatës.

Shteti i cili nuk merr masa të nevojshme për implementimin e direktivave në legjislacionin kombëtar është i obliguar që t'i përgjigjet për dëmin që mund ta pësojnë personat fizik dhe juridik. Në realizimin e politikave të Bashkimit Evropian direktivat paraqesin një mjet të rëndësishëm juridik që shërbejnë për harmonizimin e legjislacionit në fusha të ndryshme. Urdhëresat dhe direktivat nënshkruhen nga ana e kryetarit të parlamentit evropian dhe kryetarit të këshillit, pastaj shpallen në gazetën zyrtare. Dallimet kryesore në mes të urdhëresave dhe direktivave janë: Direktivat nuk krijojnë të drejta dhe obligime për personat fizik, për dallim nga urdhëresat; Urdhëresat kanë veprim direkt, ndërsa direktivat mund të kenë veprim direkt vetëm në raste të caktuara. Nëse një mardhënie rregullohet me urdhëresë, atëherë shtetet anëtare nuk do të miratojnë ligje sepse kanë veprim direkt në sistemin juridik të atij shteti. Kurse, nëse marrëdhënia rregullohet me direktivë atëherë shteti është i obliguar që ta implementoj atë me mjete dhe forma të ndryshme.

c. Vendimet janë akte juridike me të cilat rregullohen të drejtat individuale dhe juridike. Vendimet zbatohen vetëm ndaj atyre që iu drejtohen, gjegjësisht shteteve anëtare, kompanive kompanive ose personave fizik.


d. Rekomandimet dhe mendimet

Rekomandimet dhe mendimet janë dy lloje burimesh të cilat nuk janë të obligueshme dhe rekomandojnë direktiva për çështje të caktuara në shtete anëtare. Për dallim nga urdhëresat, direktivat dhe vendimet, rekomandimet nuk janë të obligueshme për shtetet anëtare dhe kanë peshë politike. Institucionet e BE-së përmes rekomandimeve shprehin qëndrimet e tyre për zhvillimin e proceseve integruese.

e. Mendimet (opinionet) nëse komisioni vëren se një shtet anëtar nuk i ka plotësuar obligimet, shteti i kërkohet të jap sqarim rreth mosplotësimit të obligimeve. Nëse, shteti nuk vepron sipas mendimit të komisionit, atëherë lënda paraqitet në gjykatën evropiane të drejtësisë. Një shtet anëtar përpara se të padisë një shtet tjetër anëtar, lëndën duhet ta paraqesë përpara komisionit. Komisioni formulon rekomandime dhe mendime. Rekomandimet dhe mendimet nuk kanë fuqi obliguese juridike, por janë mjete efikase për realizimin e proceseve integruese.

4.3 Marrëveshjet ndërkombëtare të BE-së

Burimi i tretë i të drejtës të Bashkimit ka të bëjë me rolin e BE-së në nivel ndërkombëtar. Si një nga udhëheqësit botërorë, Evropa nuk mund të kufizohet vetëm me menaxhimin e çështjeve të veta të brendshme; duhet të merret me marrëdhëniet ekonomike, sociale dhe politike me botën e jashtme. Prandaj, në të drejtën ndërkombëtare, BE-ja lidhë marrëveshje me shtetet jo-anëtare/ 'shtetet e treta' dhe me organizata të tjera ndërkombëtare. Këto marrëveshje mund të jenë nga më të ndryshmet – nga traktatet për bashkëpunim të zgjeruar tregtar ose në fushat industriale, teknike dhe sociale, e deri në marrëveshjet mbi tregtinë e prodhimeve të veçanta. Me rëndësi për t'u përmendur janë tri lloj marrëveshjesh midis BE-së dhe shteteve jo-anëtare: Marrëveshjet e asociimit, Marrëveshjet si përgatitje për anëtarësim në BE ose themelim të Bashkimit Doganor, si dhe Marrëveshja për Zonën Ekonomike Evropiane (EEA).

The image features a white background with abstract geometric shapes in the corners. The top-left corner has a dark blue vertical bar, a yellow triangular area with fine parallel lines, and a white horizontal bar. The bottom-right corner has a dark blue diagonal bar, a yellow triangular area with fine parallel lines, and a green triangular area with fine parallel lines. In the center, the number '5' is rendered in a light blue, hatched style with diagonal lines.

5

5. Procesi i zgjerimit të Bashkimit Evropian

Bashkimi Evropian, i filluar me gjashtë shtete me themelimin e Komunitetit Ekonomik Evropian/Traktati i Romës 1958, sot përfshin 28 shtete anëtare me rreth 500 milionë banorë. Integrimi i shteteve anëtare të reja ishte pjesë e idesë fillestare për krijimin e BE-së. Themeluesit kishin një vizion gjithëpërfshirës të kontinentit të Evropës, duke lënë derën të hapur për vendet e tjera demokratike evropiane për t'u bashkuar. Bashkimi Evropian është i angazhuar që të promovojë tek shtetet evropiane joanëtare vlera demokratike, posaqërisht tek shtetet që kanë treguar paraprakisht vullnet për integrim në BE. BE këtë transformim të vlerave demokratike e realizon zakonisht përmes mekanizmave kushtëzues të plotësimit të kushteve dhe kriterëve. Në gjashtë dekadat e fundit, BE u ka ndarë ndihma vendeve që synojnë të bëhen anëtare, duke promovuar zhvillimin ekonomik dhe duke mbështetur forcat demokratike në vendet që dalin nga diktatura. Në anën tjetër edhe shtetet është dashur të dëshmojnë angazhim për permbushjen e kushteve të paraqitura nga BE.

Ndryshe, zgjerimi është proces gjatë të cilit shtetet anëtarësohen në Bashkimin Evropian. Neni 49 i Traktatit për Bashkimin Evropian thekson se çdo 'vend evropian' mund të aplikojë për anëtarësi, nëse i respekton të drejtat e njeriut dhe dinjitetit njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë dhe sundimin e ligjit". Shteti kandidat 'duhet të paraqesë kërkesën në Këshill të BE-së, i cili me unanimitet pas konsultimeve me Komisionin evropian dhe pas marrjes së aprovimit nga Parlamenti evropian me shumicë absolute vendos për pranimin e shtetit kandidat në BE.

Një vend mund të bëhet anëtar vetëm nëse i plotëson kriteret dhe kushtet e anëtarësimit, siç janë të definuara nga liderët e BE-së gjatë samitit në Kopenhagë në vitin 1993, si dhe nga një varg vendimesh komplementare pasuese të BE-së. Kriteret e Kopenhagës përfshiejnë tri sete kriteresh, e që janë:

1. Kriteret politike: institucione stabile që garantojnë demokraci, ushtrim të ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektim dhe mbrojtje të pakicave;
2. Ekonomike: një ekonomi funksionale e tregut dhe kapaciteti për t'u ballafaquar me konkurrencën dhe fuqitë e tregut në BE;
3. Ligjore/acquis communautaire: nënkupton harmonizimin/përafrimin e legjislacionit me legjislacionin e BE-së.

Forma fillestare e Bashkimit përfshinte gjashtë vende (Italia, Franca, Gjermania, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu) që ndryshe quhen shtetet themeluese të BE-së. Numri i shteteve anëtare të Bashkimit Evropian është rritur në mënyrë progresive, me anëtarësimin e saj të arritur në 28 vendet me përfshirjen e Kroacisë në vitin 2013.

Në rrjedhën e historisë së zgjerimit, BE-ja ka kaluar nëpër shtatë 'valë' të zgjerimit:

1973: Britania e Madhe, Irlanda dhe Danimarka

1981: Greqia


1986: Spanja dhe Portugalia

1995: Austria, Finlanda dhe Suedia

2004: Estonia, Letonia, Lituania, Polonia, Sllovenia, Sllovakia, Republika Çeke, Hungaria, Malta dhe Qipro

2007: Bullgaria dhe Rumania

2013: Kroacia



23. Zgjerimi i BE-së në vite

Secila nga këto valë paraqet veçantitë e shteteve dhe arsyeve pse janë anëtarësuar në BE. Psh. me hyrjen e Greqisë, Spanjës dhe Portugalisë dhe të gjitha vendeve nga Evropa Qendrore dhe Lindore paraqitet një fund i sistemit komunist në këto shtete dhe një proces i tranzicionit drejt demokracisë.

Për Ballkanin Perëndimor vlejnë kushte shtesë, me c'rast shtetet kandidate për anëtarësim duhet të angazhohen për bashkëpunim rajonal dhe ndërtim të marrëdhënieve të mira me shtetet fqinje, posaçërisht meqë këto shtete kanë kaluar nëpër konflikte dhe luftëra.

Shtetet kandidate pranohen me pëlqimin unanim të shteteve anëtare të BE-së. Kur një shtet aplikon për anëtarësim në BE, qeveritë e shteteve anëtare, të përfaqësuara në Këshill, së pari vendosin nëse do të pranojnë apo jo aplikimin.

Shtetet anëtare, më pas vendosin, në bazë të opinionit nga Komisioni evropian, nëse shtetit që aplikon do t'i japin apo jo statusin e kandidatit si dhe vendosin për t'i filluar bisedimet e anëtarësimit. Ngjashëm, shtetet anëtare vendosin kur dhe me çfarë kushtesh të hapin dhe të mbyllin negociatat me kandidatin, në të gjitha fushat e politikës, duke marrë parasysh rekomandimet e Komisionit.

Pas përfundimit të kënaqshëm të negociatave të anëtarësimit, hartohet traktati i anëtarësimit dhe nënshkruhet nga shtetet anëtare dhe nga vendi përkatës kandidat.

Parlamenti evropian, deputetët e të cilit zgjidhen drejtpërdrejtë nga qytetarët e BE-së, gjithashtu duhet të japë pëlqimin e vet. Pastaj, traktati duhet të ratifikohet nga të gjitha shtetet anëtare dhe vendi aderues, në pajtim me procedurat e tyre të themeluara kushtetuese.

5.1 Negociatat e anëtarësimit

Negociatat e anëtarësimit kanë të bëjnë me aftësinë e shtetit kandidat për t'i marrë përsipër obligimet që dalin nga procesi i anëtarësimit. Negociatat përqëndrohen në kushtet dhe kohën kur kandidati i implementon/zbaton ligjet dhe rregullat ekzistuese të BE-së (rreth 100 000 faqe) ndaj shteteve kandidate. Rregullat dhe kushtet për anëtarësim nuk janë të negociueshme. Negociatat janë para së gjithash çështje e pajtimit për atë se si dhe kur kandidati do të miratojë dhe implementojë ligjet dhe procedurat e BE-së në mënyrë efektive. Negociatat përcillen me një mekanizëm kushtëzues ndaj vendit kandidat.

Negociatat zhvillohen mes shteteve anëtare të BE-së dhe vendit kandidat; Intenziteti i negociatave varet kryesisht nga progresi i shtetit kandidatit në plotësimin e kërkesave. Rjedhimisht, kandidatët motivohen të implementojnë reformat e nevojshme në mënyrë të shpejtë dhe efektive. Reformat të cilat duhet të ndërmerren shteti kandidat janë përmbajtësore dhe kërkojnë ndryshime të thella dhe ndonjëherë të vështira të strukturave politike dhe ekonomike të vendit. Prandaj, është me rëndësi që qeveritë t'i bëjnë këto reforma në mënyrë transparente dhe të ua sqarojnë qytetarëve arsyet e këtyre reformave në mënyrë të qartë. Në këtë proces është me rëndësi thelbësore mbështetja e shoqërisë civile, krahas aktiviteteve të institucioneve publike.

Hapja e negociatave të anëtarësimit vendoset nga Këshilli Evropian, në bazë të një rekomandimi të Komisionit, pasi që vendi kandidat të ketë plotësuar në mënyrë të kënaqshme kriteret politike të Kopenhagës dhe kushte të tjera të mundshme.

5.2 Vlerësimi


Negociatat për anëtarësim ndahen në kapituj, ku secili prej tyre korrespondon me një fushë të politikës së veçantë. Hapi i parë i negociatave quhet 'screening' (vlerësim); qëllimi i tij është t'ia sqarojë acquis-n shtetit kandidat dhe të identifikojë fushat që kanë nevojë për harmonizim të legjislativës, institucioneve ose praktikës së tyre.

1. Lëvizja e lirë e mallrave
2. Liria e lëvizjes për punëtorët
3. E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar Shërbime
4. Lëvizja e lirë e kapitalit
5. Prokurimi publik
6. Ligji i kompanive
7. Ligji mbi pronësinë intelektuale
8. Politika e konkurrencës
9. Shërbimet financiare
10. Shoqëria e informacionit dhe media
11. Bujqësia dhe zhvillimi rural
12. Siguria e ushqimit, politika veterinare dhe fitosanitare
13. Peshkatari
14. Politika e transportit
15. Energjia
16. Tatimet
17. Politika ekonomike dhe monetare
18. Statistikat
19. Politika sociale dhe punësimi
20. Ndërmarrja dhe politika industriale
21. Rrjetet Trans-Evropiane
22. Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore
23. Gjyqësori dhe të drejtat themelore
24. Drejtësia, liria dhe siguria
25. Shkenca dhe kërkimi
26. Edukimi dhe kultura
27. Mjedisi
28. Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit
29. Bashkimi doganor
30. Marrëdhëniet e jashtme
31. Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes
32. Kontrolli financiar
33. Dispozitat financiare dhe buxhetore
34. Institucionet
35. Çështje të tjera

Si bazë për të filluar procesin e negociatave, Komisioni përpilon raporte vlerësimi për çdo kapitull, që ia dorëzon Këshillit. Komisioni jep rekomandim nëse duhet të hapen negociatat për kapituj, ose të kërkojë së pari plotësimin e kushteve dhe kriterëve të caktuar.

Secili shtet duhet të vendosë, në bazë të vlerësimit të Komisionit, nëse janë plotësuar kriteret e hapjes së kapitullit, derisa vendi kandidat dorëzon qëndrimin negociues. Atëherë, Këshilli miraton një qëndrim të përbashkët të BE-së, përsëri të bazuar në propozimin e Komisionit, i cili lejon hapjen e negociatave për atë kapitull. Qëndrimi i përbashkët i BE-së gjithashtu përfshin kushtet dhe kriteret për mbylljen e kapitullit.

Pas prezantimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve të kapitullit përkatës, shtetet anëtare miratojnë një qëndrim të ri të përbashkët i cili konkludon se kapitulli mund të mbyllet, por jo definitivisht. Negociatat e anëtarësimit në BE funksionojnë në parimin se 'asgjë nuk është dakorduar derisa të pajtohemi për gjithçka', kështu që përmbyllja definitive e kapitujve ndodh vetëm në fund të gjithë procesit negociues.



25. 'Pengesat' drejt BE-së

5.3 Raportimi dhe mbikqyrja

Komisioni informon Parlamentin Evropian dhe Këshillin lidhur me progresin e vendeve aspiruese, përmes dokumenteve strategjike vjetore dhe raporteve mbi progresin individual të vendeve. Ai gjithashtu mbikqyrë se sa i respekton vendi kandidat angazhimet që i ka marrë përsipër gjatë negociatave.

Mbikqyrja vazhdon deri në anëtarësim. Kjo bën të mundur dhënien e udhëzimeve shtesë gjatë periudhës kur vendet marrin përgjegjësitë e anëtarësimit, dhe gjithashtu u garanton shteteve anëtare se anëtarët e rinj i plotësojnë kushtet e anëtarësimit.

5.4 Traktati i anëtarësimit

Pas përfundimit të negociatave mbi të gjithë kapitujt, në nivel të kënaqshëm për të dyja palët, rezultatet përfshihen në një propozim traktati për anëtarësim. Pastaj konsultohet Komisioni, kurse Parlamenti evropian duhet ta japë pëlqimin e vet. Pastaj nënshkruhet traktati dhe ratifikohet nga vendi kandidat dhe të gjitha shtetet anëtare.

Pasi të jetë nënshkruar traktati i anëtarësimit, shteti aderues ka të drejtë për disa privilegje të caktuara të përkohshme. Shteti fiton 'statusin e mbikqyrësit aktiv' në shumicën e institucioneve dhe agjencive të BE-së, ku ka të drejtë të drejtë pjesëmarrjeje, por jo të votojë; por njëkohësisht mund të komentojë propozimet, komunikatat, rekomandimet ose iniciativat e BE-së. Pas përfundimit të procesit të ratifikimit, traktati i anëtarësimit hyn në fuqi në datën e caktuar, dhe vendi aderues bëhet shtet anëtar i BE-së.

5.5 Ndhima për vendet për anëtarësim

Për t'u ndihmuar vendeve të përgatiten për anëtarësi të ardhshme, BE-ja ka një strategji para-anëtarësimi.

Elementet kryesore të kësaj strategjie janë marrëveshjet e asociimit (marrëveshjet e stabilizimit dhe asociimit në rastin e Ballkanit Perëndimor), ndihma financiare e BE-së dhe pjesëmarrja në programet e BE-së. Korniza kontraktuese e vendeve të zgjerimit për marrëdhëniet me BE-në, parashikohet me anë të marrëveshjeve të asociimit.

Bashkimi Evropian ka krijuar një proces special në vitin 1999 për vendet e Ballkanit Perëndimor i quajtur Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit (SAP).

Përgatitja e vendeve për anëtarësim nënkupton modernizimin e infrastrukturës së këtyre vendeve dhe marrjes së kredive nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Vendeve kandidatë u mundësohet të marrin pjesë në programe të BE-së, për shembull në fushën e shëndetit publik, hulumtimit ose arsimit, etj. Në këtë mënyrë, BE-ja u ndihmon vendeve në zgjerim për t'u bërë ekonomi konkurruese të tregut. Vendet e zgjerimit duhet të realizojnë një numër të madh reformash për të siguruar miratimin e rregullave të BE-së, por edhe implementimin e duhur të tyre. Ato do të duhet të krijojnë organe të reja si një autoritet i pavarur konkurrues ose një agjenci për standardet ushqimore. Shtetet shpeshherë duhet të ristrukturojnë institucionet ekzistuese me qëllim të demokratizimit dhe funksionalizimit të tyre. Këto reforma nënkuptojnë investime të mëdha dhe kapacitete njerëzore që i kuptojnë këto fonde dhe kanë njohuri për aplikimet në grantet e BE-së. BE-ja ofron një llojllojshmëri të programeve dhe mekanizmave për ndihmë financiare dhe teknike në realizimin e këtyre reformave. BE-ja ndër të tjera, promovon të kuptuarit publik të procesit të anëtarësimit në BE, meqë qytetarët duhet të jenë pjesë e transformimit të shtetit kandidat. Në këtë proces transformues është e rëndësishme të përfshihet shoqëria civile, por edhe unionet tregtare, shoqatat e konsumatorëve dhe organizatat e tjera joqeveritare. Kurse një aspekt me rëndësi në të cilin kontribuon BE është forcimi i institucioneve publike. Kjo do të thotë të garantohet që sektori publik në vendin aspirues të posedojë njohuri si të punojë në raport me BE-në në mënyrë efektive dhe demokratike. BE-ja ndihmon në zhvillimin e strukturave ose trajnimin e stafit përgjegjës për zbatimin e rregullave të BE-së. Këshillat më adekuate mbi implementimin e acquis shpesh ofrohen përmes marrëveshjeve 'twinning', ku delegohen ekspertë nga shtetet anëtare të BE-së, ose përmes punëtorive të ndryshme.

5.6 Mbështetja e BE-së në procesin e anëtarësimit

Transformimi i vlerave evropiane dhe 'imponimi' i reformave që lidhen me kushtet dhe kriteret për anëtarësim, bëhet përmes ndihmës financiare që e ndan BE në baza vjetore.

Duke filluar nga viti 1991 deri në vitin 2011, BE-ja ofroi më se 16 miliardë euro ndihma për Ballkanin Perëndimor, disa nga ndihmat më të larta botërore për frymë njeriu. Nga viti 2007, vendet kandidatë dhe potenciale kandidatë kanë pranuar fonde dhe mbështetje të BE-së, përmes Instrumentit për Ndihmë Para-anëtarësuese, ose IPA. BE-ja dhe institucionet vendore të vendeve përkatëse vendosin se cilat do të jenë fushat ku do të investohen këto fonde. Institucionet publike të shtetit kandidat aplikojnë për përkrahje nga fondet e IPA-s të cilat kanë për qëllim të forcojnë institucionet demokratike, ushtrimin e ligjit, të reformojnë administratën publike, të mbështesin reformat ekonomike, të promovojnë respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtat e pakicave, barazinë gjinore, të përkrahin zhvillimin e shoqërisë civile, të avancojnë bashkëpunimin rajonal, dhe të kontribuojnë në zhvillimin e vazhdueshëm dhe zvogëlimin e varfërisë. Fondet IPA mbështesin me përparësi projektet që u përgjigjen plotësisht të kushteve dhe kriterëve të paraqitura nga BE për anëtarësim. Fondet e përgjithshme para-anëtarësuese për periudhën 2014–20 janë paraparë të jenë rreth 11.7 miliardë, me shpërndarje precize që do të vendoset vit pas viti.

Shteti	2014	2015	2016	2017	2018-2020	Total
Shqipëria	83.7	84.9	87.7	92.9	296.3	649.5
Maqedonia	85.7	88.9	91.6	94.9	303.1	664.2
Kosova	83.8	85.9	88.7	91.9	295.1	645.5
Mali i Zi	39.6	35.6	37.4	39.5	118.4	270.5
Serbia	195.1	201.4	207.9	215.4	688.2	1,508.0
Turqia	620.4	626.4	630.7	636.4	1,940.0	4,453.9
Tjera	384.0	365.0	390.0	410.4	1,445.3	2,958.7

The background features several geometric elements: a yellow triangle with fine parallel lines in the top-left corner; a dark blue vertical bar on the left side; a large, stylized number '6' composed of fine parallel lines in the center; a dark blue diagonal bar in the bottom-right corner; and a yellow triangle with fine parallel lines in the bottom-right corner, partially overlapping the dark blue bar.

6

6. Ballkani Perëndimor dhe Bashkimi Evropian

Perspektiva evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor ku bën pjesë edhe Kosova është vërtetuar në Samitin e Selanikut të mbajtur me 21 Qershor të vitit 2003. Në këtë samit të gjithë pjesëmarrësit përfaqësues të lartë të Bashkimit Evropian dhe përfaqësues të shteteve të Ballkanit kanë nënshkruar deklaratën që sqaronte perspektivën evropiane të shteteve të Ballkanit Perëndimor, duke obliguar që këto shtete të plotësojnë Kriteret e Kopenhagenit. Këtu u bë e qartë së integrimi i shteteve do të behet varësisht nga progresi i arritur nga secili shtet.

Korniza politike e BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor deri në pranim të plotë të tyre mbështetet në Mekanizmin e Stabilizim-Asociimit, i cili është krijuar nga BE në vitin 2002 e që rezulton në nënshkrimin e Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit për secilin shtet të Ballkanit Perëndimor.

Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor janë në raporte kontraktuale me BE-në, por jo në faza të njëjta të integritit. Ato kanë nënshkruar Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit (MSA), e cila parasheh një sërë masash dhe veprimesh, të përcjellë me ndihmë të konsiderueshme financiare nëpërmjet Instrumentit të Ndhmës së Para-Anëtarësimit - IPA. Instrumentet e Procesit të Stabilizim-Asociimit janë formuluar në Samitin e Zagrebit në nëntor të vitit 2000, ndërsa samiti i Selanikut e ka plotësuar këtë proces me një sërë instrumentesh të reja.

Në fuqi janë gjashtë Marrëveshje të Stabilizim Asociimit (SAA): me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (2004), Shqipëri (2009), Mal të Zi (2010) dhe Serbi (2013), Bosnjë dhe Hercegovinë (2015) dhe Kosovë (2016).

Këto marrëveshje synojnë që në mënyrë progresive të krijojnë një zonë të tregtisë së lirë midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Më saktë, këto marrëveshje kanë tri qëllime kryesore: stabilizimin dhe tranzicionin e shpejtë në ekonominë e tregut, promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe perspektivën për anëtarësim në BE. Ato poashtu përqëndrohen në liberalizimin e tregtisë së mallrave, në rradhitje të rregullave mbi praktikën BE-së dhe mbrojtjen e pronësisë intelektuale.

Në këtë mënyrë sigurohet reformë ekonomike, reformë institucionale, mbështetje financiare, liberalizim të tregut dhe mbështetje të demokracisë dhe legjislacionit.



27. Samiti i Parisit për Ballkanin Perëndimor


Perspektiva evropiane e Ballkanit Perëndimor është sqaruar edhe në Komunikatën e Komisionit evropian për 'Ballkanin Perëndimor: Përforcimi i perspektivës Evropiane' (Mars 2008), dhe Komunikatën e vitit 2016 mbi politikën e zgjerimit të BE-së.

BE i mbështet fuqishëm anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor edhe në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT).



Përfundimisht, partneriteti ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor është në interes të Bashkimit Evropian, por edhe në interes të vendeve të Ballkanit Perëndimor nëpërmes arritjes së paqes, stabilitetit, lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, cilësisë së jetës etj.

Procesi i Berlinit i cili u prezantua në vitin 2015 ka nënkuptuar një qasje të re ndaj Ballkanit Perëndimor në të cilën BE alokon iniciativa të ndryshme për të bërë shtetet që të pwrparojnë në bashkëpunim rajonal dhe përmirësim të relacioneve të shteteve në mes tyre. Në këtë proces janë prezantuar disa iniciativa të reja të krahas mbështetjes institucionale shtetërore: RYCO (Regional Youth Cooperation Office- Zyra regjionale për bashkëpunim të rinisë), Civil Society Forum (Forum i për shoqëri civile), etj.





Janë mbajtur një sërë Samitesh të liderëve të BE-së për t'a vazhduar dhe përcjellur me iniciativa te reja procesin e Berlinit. Në vitin 2016 liderët u mblodhën në **Samitin e Vjenës** në të cilin nxorrën këto përfundime: Ndërlidhja infrastrukturore, rrugore dhe energjetike, midis vendeve të rajonit dhe BE-së; Thellimi i bashkëpunimit për çështje të arsimit, kualifikimit, punësimit dhe lëvizshmërisë e rinisë; Përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe; dhe Adresimin e sfidave të përbashkëta të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ato të BE.

Në **Samitin e Triestës** u nxorrën këto përfundime: Diskutimet në tri fusha kyçe të bashkëpunimit rajonal:

1. Lidhshmëria: implementimin e Agjendës së lidhshmërisë, e cila synon krijimin e kushteve për rritje ekonomike dhe marrëdhënie të mira fqinjësore, në veçanti përmes përgatitjes dhe financimit të projekteve konkrete të investimeve në infrastrukturë rajonale në sektorët e transportit dhe energjisë.
2. Integrimi rajonal ekonomik/zhvillimi i sektorit privat: plan veprimi për të zhvilluar një Zonë Ekonomike Rajonale me qëllim të rritjes së tërheqjes të rajonit për të rritur investimet dhe për të gjeneruar vende pune, veçanërisht nëpërmjet rritjes së zgjuar, bizneseve të reja dhe rritjes së kapacitetit

3. Tregu digjital (integrimin e rajonit në tregun digjital panevropian)

4. Forcimi i kontakteve në mes njerëzve (Forumi Rinor Rajonal, RYCO, Erasmus+)

Kurse, në **Samitin e Londrës** i cili u mbajt në vitin 2019 u ripërsërit perspektiva e evropiane e Ballkanit Perëndimor për integrim në BE; u diskutua për adresimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë; Rritjen e përkushtimit dhe hapjen e perspektivave ndaj gjeneratës së të rinjve; dhe Forcimin e angazhimeve të vendeve të rajonit ndaj demokracisë, sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Kurse në vitin 2019 u mbajt Samiti i Poznanit, në të cilën u konkludua: Zbatimi i Planit Shumëvjeçar të Veprimit të Zonës Ekonomike Rajonale (MAP REA); Kapërcimin e vështirësive që të arrijnë prioritetet e përcaktuara për 2019/20 të përshkruara nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe CEFTA; Deklarata për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë; Planeve të Veprimit Individual të Reformës në linjë me axhendën rajonale të reformës së investimeve; Përpjekjet e bashkëpunimit rajonal në fushën e diversifikimit e tregjeve financiare, me fokus në tregjet e kapitalit që kanë për qëllim zgjerimin e aksesit financave në Ballkanin Perëndimor; 8 lidhje të reja projekte investimi me një vlerë totale investimi prej mbi 700 milionë euro. Këto investime do të do të financohet nga 180 milionë euro bashkëfinancim nga Bashkimi Evropian dhe bilanci i BE-së nëpërmjet huave nga BEI, BERZH dhe KfW, të plotësuara nga fondet kombëtare. Mbështetja e projekteve të reja sjell financimin total të infrastrukturës së lidhjes në kuadrin e Axhendës së Lidhjes që nga viti 2015 në më shumë se 880 milionë euro në grantet e BE-së për gjithsej 39 projekte me kosto investimi prej më shumë se 3.2 miliardë euro.

Ne vitin 2020 u mbajt një samit virtual, i quajtur Samiti i Zagrebit në mes liderëve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në të cilin përveç se u rikonfirmua perspektiva evropiane u diskutuan edhe sfidat e shkaktuara nga pandemia Covid 19. Me këtë rast BE konfirmoi një paketë prej mbi 3.3 miliardë euro në të mirë të Ballkanit Perëndimor për të mbështetur sektorin shëndetësor, për të mbështetur rimëkëmbjen sociale dhe ekonomike dhe për të siguruar ndihmë përmes Bankës Evropiane të Investimeve, si dhe ndihmë makro-financiare'.



7. Kosova dhe Bashkimi Evropian

Kosova ka shpallur Pavarësinë më 17 shkurt 2008 në Kuvendin e Kosovës. Njohja e shtetit të Kosovës deri më tash është bërë nga 114 shtete të botës, poashtu nga shumica e shteteve të BE-së, përjashtimisht Spanjës, Rumanisë, Qipros, Greqisë dhe Sllovakisë. Si rezultat i kësaj, Bashkimi Evropian i referohet vetëm "Kosovës*" e që nënkupton se „Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës'. Përkundër kësaj, Parlamenti Evropian, në vitin 2010 miratoi një rezolutë, që u bën thirrje të gjitha shteteve anëtare të njohin Kosovën.

Për shkak të mos njohjes së pavarësisë nga Serbia, Kosovës i janë paraqitur pengesa për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, integrimet evropiane dhe regionale.

Edhe pse Bashkimi Evropian nuk e njeh Kosovën si shtet, përderisa pesë shtete të saj nuk kanë qëndrim ndaj statusit të Kosovës, BE ka gjetur rrugë të përfshirjes së Kosovës në proceset integruese dhe ndihmës financiare. Kosova konsiderohet zyrtarisht si një kandidat potencial për anëtarësim nga Bashkimi Evropian me ç'rast i është dhënë një "perspektivë evropiane" e qartë nga Këshilli i Bashkimit Evropian.

Që në vitin 2005, Komisioni Evropian i paraqiti Këshillit një Komunikatë për Kosovën të quajtur "Një Ardhmëri Evropiane për Kosovën" e cila përforcoi angazhimin e Komisionit për Kosovën.

Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes miratuan një Plan Veprimi për Zbatimin e Partneritetit Evropian në gusht të vitit 2006 dhe IPVQ-ja raportoi rregullisht për zbatimin e këtij plani të veprimit.



28. Flamuri i BE-së dhe Republikës së Kosovës

Në vitin 2008, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Këshilli i ministrave të BE-së miraton Veprimin e përbashkët që themelon Misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë- EULEX.

EULEX ishte misioni më i madh civil që është iniciuar ndonjëherë nën autoritetin e Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Evropës. Ky mision kishte për qëllim dhënien e ndihmës për institucionet e Kosovës në sferën e sundimit të ligjit, veçanërisht në polici, në sistemin gjyqësor dhe në dogana. EULEX ishte një mision teknik drejtues, monitorues dhe këshillues, i cili ka mbajtur njëkohësisht një sërë pushtetesh të caktuara ekzekutive.

Në qershor 2010, këtij misioni ju vazhdua mandati për një periudh prej dy vitesh. Vazhdimi i fundit i mandatit të këtij Misioni ju bë në qershor 2014 të shoqeruara me ndryshime të mëdha në kompetencat e tij. Mandati aktual i EULEX-it skadon më 14 qershor 2018.

Në vitin 2009, Komisioni Evropian publikon dokumentin e quajtur 'Kosova-Përmbushja e perspektivës evropiane', me të cilin rikonfirmohej perspektiva evropiane integruese në realitetin e ri pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Në këtë komunikatë identifikoheshin sfidat e Kosovës dhe inkurajoheshin institucionet që të punonin më shumë në rrugën drejt BE-së.



29. Selia e EULEX në Prishtinë, Kosovë

Në vitin 2012 u publikua Studimi i fizibilitetit mbi perspektivat për procesin e Stabilizim Asociimit me Kosovën nga Komisioni evropian. Ai konstatoi se nuk kishte pengesa ligjore për t'u nënshkruar Marrëveshja me Kosovën, pasi sovraniteti i plotë nuk kërkohej për një marrëveshje të tillë dhe rekomandoi që negociatat të fillojnë sa më shpejt që Kosova të kishte bërë përparim të mëtijshëm në katër fusha: "Sundimi i ligjit, Administrata publike, Mbrojtja e Pakicave dhe tregtisë".



Në vitin 2012, Komisioni evropian filloi Procesin e Liberalizimit të Vizave Schengen me Kosovën. Më 14 qershor 2012, Kosova mori një udhërrëfyes për liberalizimin e vizave, duke detajuar reformat e kriteresh të nevojshme për t'u plotësuar nga Kosova. Me liberalizim të vizave nënkuptohet lëvizja e lirë në zonën Schengen. Zona Schengen përfshinë: Austrinë, Belgjikën, Republikën Çeke, Danimarkën, Estoninë, Finlandën, Francën, Gjermaninë, Greqinë, Hungarinë, Islandën, Italinë, Letoninë, Litenshtajnin, Lituaniën, Luksemburgun, Maltën, Holandën, Norvegjinë, Poloninë, Portugalinë, Sllovakinë, Slloveninë, Spanjën, Suedinë dhe Zvicrën. Komisioni evropian në mes të viteve 2012-2016 miratoi tri Raporte mbi përparimin e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave. Në raportin e katërt, Komisioni Evropian konkludoi se Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret, përjashtimisht dy kriterëve: Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi dhe të dhëna më të shumta lidhur me luftën kundër korrupsionit. BE-ja ka përcaktuar që qasja e lirë e vizave për qytetarët e Kosovës në zonën e Shengenit të jetë e kushtëzuar nga miratimi i marrëveshjes së kufirit me Malin e Zi. Pas miratimit të demarkacionit më 2018, Kosova është në negociata të mëtejme me shtetet hezituese për liberalizim të vizave.

Një proces tjetër i rëndësishëm i ndërmjetësuar nga BE është procesi i Dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ky 'Dialog' është bërë pjesë e kriterëve për integrimin e të dyja vendeve në BE. Marrëveshja e parë është nënshkruar më 19 prill 2013 nga Qeveria e Kosovës dhe Qeveria e Serbisë, e që i detyron të dyja shtetet të mos "bllokojnë ose inkurajojnë të tjerët që të bllokojnë progresin e palës tjetër në rrugët përkatëse të BE-së." Disa ditë pasi u arrit marrëveshja, Komisioni evropian rekomandoi fillimin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës, si dhe fillimin e negociatave të anëtarësimit në BE me Serbinë.

Komisioni evropian që nga viti 2005 ka publikuar Raporte të Progresit për Kosovën, duke i vlerësuar arritjet, por edhe sfidat e Kosovës në rrugën drejt BE-së. Më saktë matej edhe progresi i institucioneve të Kosovës, punët dhe detyrat të cilat dilnin nga Planet e Veprimit. Raporti i fundit i Progresit ka identifikuar sfida që kishin të bënin me demokratizimin, refoma në administratën publike, sundimin e ligjit, luftimin e korrupsionit, refoma në ekonomi, refoma sociale, etj.

Në vitin 2015 u nënshkrua Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian, si hapin e parë kontraktual në mes të BE-së dhe Kosovës. Kjo ishte Marrëveshja e parë e nënshkruar pas hyrjes në fuqi të traktatit të Lisbonës, i cili i dha personalitet juridik BE-së. MSA hyri në fuqi më 1 prill 2016.

Me këtë Marrëveshje është vendosur një Asociim ndërmjet BE-së dhe Kosovës. Qëllimet e kësaj Marrëveshje janë:

- (a) të mbështesë përpjekjet e Kosovës për forcimin e demokracisë dhe shtetin e së drejtës;
- (b) të kontribuoj në stabilitetin politik, ekonomik dhe institucional në Kosovë si për stabilizimin e rajonit;
- (c) të sigurojë një strukturë të përshtatshme për dialogun politik, duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet Palëve;
- (d) të mbështesë përpjekjet e Kosovës për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, nëse lejojnë rrethanat objektive, gjithashtu edhe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të saj me atë të BE-së;
- (e) të mbështesë përpjekjet e Kosovës për të përfunduar tranzicionin në një ekonomi funksionale të tregut;
- (f) të promovojë marrëdhënie ekonomike të harmonizuara dhe të zhvillojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet BE-së dhe Kosovës;
- (g) të nxisë bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat e trajtuara me këtë Marrëveshje.

Bashkimi Evropian mbështet Kosovën përmes fondeve të IPA-s/ Instrumenti i para anëtarimit. Për Kosovën janë ndarë më se: 645.5 milion euro për t'u shpenzuar në mes të viteve 2014-2020.

Pritet që financimi në këtë periudhë do të kontribuojë në arritjen e të gjitha rezultateve të renditura në sektorët e mëposhtëm prioritarë:

1. Demokraci dhe qeverisje

Riformimi i shërbimit civil (përmirësimi i besueshmërisë, transparencës, llogaridhënies); Ofrimi më efikas i shërbimeve publike; Krijimin e institucioneve demokratike, forcimin e demokracisë ekzistuese (qeverisjen vendore, Kuvendin, organet e pavarura mbikëqyrëse).

2. Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore

Forcimi i sundimit të ligjit; Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; Zbatimin e ligjit për të drejtat e njeriut, dhe mbrojtjen dhe përfshirjen e grupeve minoritare dhe të cenueshme.

3. Energji

Reformimi i sektorit të energjisë për të trajtuar problemet kryesore shëndetësore dhe mjedisore; Sigurimi i një furnizimi të besueshëm dhe të qëndrueshëm të energjisë; Përdorimi më i madh i energjive të rinovueshme; Përafrimi me ligjin energjetik të BE-së.

4. Konkurrueshmëria dhe inovacioni

Hartimi dhe zbatimi i politikave të konkurrencës; Ofrimin e shërbimeve publike që plotësojnë nevojat e sektorit privat.

5. Arsimi, punësimi dhe politikat sociale


Përmirësimi i funksionimit të tregut të punës; Ngritja e standardeve të arsimit; Nxitja e zhvillimit të shkathësive; Ristrukturimin e sistemit të mirëqenies sociale.

6. Bujqësia dhe zhvillimi rural

Rritja e konkurrencës në bujqësinë dhe prodhimin e ushqimit, dhe ngritja e standardeve të sigurisë ushqimore; Përmirësimin e standardeve të jetesës në rajonet rurale, ndërtimin e një ekonomie rurale të qëndrueshme ndaj klimës.

7. Bashkëpunimi rajonal dhe territorial

Përmirësimi i marrëdhënieve rajonale dhe fqinjësore përmes programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar. Këto fusha janë përcaktuar pas identifikimit të sfidave me të cilat ballafaqohet Kosova, por edhe pas përcaktimit të fushave prioritare nga ana e Qeverisë së Kosovës. Bashkimi Evropian do të vazhdojë të vlerësojë punën e institucioneve të Kosovës me anë të Raporteve të Progresit.

The background features several geometric elements: a top-left corner with a grey-to-white gradient and a yellow-to-white gradient; a dark blue vertical bar on the left; a diagonal band in the bottom right consisting of dark blue, olive green, and yellow sections; and a yellow-to-white gradient in the bottom right corner. The central focus is a large number '8' composed of fine, parallel blue lines.

8

8. Des-integrimi i BE-së

Që nga miratimi i Traktatit të Lisbonës krahas anëtaresimit të shteteve të reja në BE është paraparë edhe dalja e vullnetshme e shteteve nga BE. Procesi i daljes së shtetit nga BE është paraparë në Nenin 50 të Traktatit të Lisbonës i cili parasheh hapat e procedurës së largimit. Shteti i parë që e ka shfrytëzuar këtë të drejtë është Mbretëria e Bashkuar.

ARTICLE 50

The Lisbon Treaty

1. Any Member State may decide to withdraw from the Union in accordance with its own constitutional requirements.
2. A Member State which decides to withdraw shall notify the European Council of its intention. In the light of the guidelines provided by the European Council, the Union shall negotiate and conclude an agreement with that State, setting out the arrangements for its withdrawal, taking account of the framework for its future relationship with the Union. That agreement shall be negotiated in accordance with Article 218(3) of the Treaty on the Functioning of the European Union. It shall be concluded on behalf of the Union by the Council, acting by a qualified majority, after obtaining the consent of the European Parliament.
3. The Treaties shall cease to apply to the State in question from the date of entry into force of the withdrawal agreement or, failing that, two years after the notification referred to in paragraph 2, unless the European Council, in agreement with the Member State concerned, unanimously decides to extend this period.
4. For the purposes of paragraphs 2 and 3, the member of the European Council or of the Council representing the withdrawing Member State shall not participate in the discussions of the European Council or Council or in decisions concerning it.
A qualified majority shall be defined in accordance with Article 238(3)(b) of the Treaty on the Functioning of the European Union.
5. If a State which has withdrawn from the Union asks to rejoin, its request shall be subject to the procedure referred to in Article 49.


8.1 BREXIT

BREXIT është quajtur procesi i daljes së Mbretërisë së Bashkuar nga BE, e cila për here të parë pas 47 vjet anëtarësimi kërkoi largimin nga BE duke u bërë shteti i parë që largohet nga Unioni. Mbretëria e Bashkuar ishte bashkangjitur Komunitetit Evropian (KE), në 1 Janar 1973, por integrimi i saj ishte i pjesshëm duke mos i nënshkruar disa nga marrëveshjet e BE-së, psh. Marrëveshjen e Shëngnit dhe EURO-n.

Procesit të daljes së Britanisë nga BE i parapriu një referendum i mbajtur në qershor 2016, në të cilin 52% votuan në favor të largimit nga BE dhe 48% votuan për të mbetur anëtar, me c'rast Kryeministri David Cameron dha dorëheqjen. Më 29 Mars 2017, Qeveria e re e Mbretërisë së Bashkuar e udhëhequr nga Theresa May njoftoi zyrtarisht BE-në për qëllimin e vendit për t'u tërhequr, duke filluar procesin e Brexit. Tërheqja ishte planifikuar fillimisht për 29 Mars 2019, por dështoi meqë dështuan edhe shumë negociata ne mes te dy palëve. Vonesa pati edhe për shkak të bllokimit në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2017, e cila rezultoi në një parlament të varur në të cilin Konservatorët humbën shumicën e tyre por mbeti partia më e madhe.


Marrëveshja e tërheqjes u ratifikua nga Mbretëria e Bashkuar në 23 Janar kurse nga BE në 30 Janar, e cila Marrëveshje hyri në fuqi më 31 janar 2020.

Procesi i daljes se Mbretërisë së Bashkuar nga BE:



Shtojca 1. Themeluesit e Bashkimit Evropian

Konrad Adenauer



Një demokrat pragmatik dhe unifikues i palodhur

Kancelari i parë i Republikës Federale të Gjermanisë, i cili qëndronte në krye të shtetit të sapoformuar nga 1949-63, ndryshoi historisë gjermane dhe evropiane të pasluftës më shumë se çdo individ tjetër.

Një gur-themel i politikës së jashtme të Adenauer-it ishte pajtimi me Francën. Së bashku me presidentin francez Charles de Gaulle arriti një pikë kthese historike: në vitin 1963 armiqtë e dikurshëm Gjermania dhe Franca nënshkruan një traktat miqësie, i cili u bë një nga momentet në rrugën drejt integritimit evropian.

Winston Churchill



Duke bërë thirrje për një „Shtete të Bashkuara të Evropës“

Winston Churchill, një ish-oficer i ushtrisë, gazetar i luftës dhe kryeministër britanik (1940-45 dhe 1951-55), ishte një nga të parët që bënë thirrje për krijimin e një 'Shteteve të Bashkuara të Evropës'. Pas Luftës së Dytë Botërore, ai ishte i bindur se vetëm një Evropë e bashkuar mund të garantojë paqen. Qëllimi i tij ishte të eliminonte njëherë e përgjithmonë të metat evropiane të nacionalizmit dhe të luftës.

Jean Monnet



Forca e bashkimit pas lindjes së Bashkimit Evropian

Këshilltari francez politik dhe ekonomik Jean Monnet iu dedikua integritit evropian. Ai ishte i frymëzuar pas 'Planit të Schuman'-it, i cili parashikonte bashkimin e industrisë së rëndë evropiane perëndimore.

Monnet ishte nga rajoni Konjaku i Francës. Kur e la shkollën në moshën 16 vjeçare, ai udhëtoi nëpër botë si tregtar, më vonë edhe si bankier. Gjatë dy luftërave botërore ai mbajti poste

Robert Schuman



Arkitekt i projektit të integritit evropian

Robert Schuman, një avokat i kualifikuar dhe ministër i jashtëm francez midis 1948 dhe 1952, konsiderohet si një nga etërit themelues të unitetit evropian.

Në bashkëpunim me Jean Monnet, ai hartoi Planin Schuman të njohur ndërkombëtarisht, të cilin e publikoi më 9 maj 1950, data e tanishme e konsideruar si lindja e Bashkimit Evropian, Dita e Evropës. Ai propozoi kontroll të përbashkët të prodhimit të thëngjillit dhe çelikut, materialet më të rëndësishme për industrinë e armatimeve. Ideja themelore ishte se kushdo që nuk kishte kontroll mbi prodhimin e thëngjillit dhe çelikut nuk do të ishte në gjendje të luftonte një luftë.


Paul-Henri Spaak



Një vizionar evropian dhe një personi i talentuar, politikan belg

Spaak ishte një figurë udhëheqëse në formulimin e përmbajtjes së Traktatit të Romës. Në 'Konferencën e Messinës' në vitin 1955, gjashtë qeveritë pjesëmarrëse e caktuan atë president të komitetit të punës që përgatiti Traktatin.

Altiero Spinelli



Një federalist i dalluar

Politikani italian Altiero Spinelli ishte një nga etërit e Bashkimit Evropian. Ai ishte figura kryesore pas propozimit të Parlamentit Evropian për një traktat mbi një Bashkim Evropian federal - i ashtuquajtur 'Plani Spinelli'. Kjo u miratua në vitin 1984 nga një shumicë dërrmuese në Parlament dhe dha një frymëzim të rëndësishëm për forcimin e Traktateve të BE-së në vitet '80 dhe '90.

Shtojca 2: Përfaqësimi i BE-së në Kosovë¹

Bashkimi Evropian është prezent në Kosovë: me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë / Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Misionin e EULEX-it.

Zyra e BE-së në Kosovë

Zyra e BE-së luan rol shumë të rëndësishëm në realizimin e agjendës evropiane në Kosovë me qëllim që ta përkrahë përafrimin e Kosovës me Bashkimin Evropian. Duke qenë pjesë përbërëse e Shërbimit të Jashtëm Evropian dhe përfaqësisë së Komisionit Evropian në Prishtinë, Zyra siguron mbajtjen e dialogut të përhershëm politik dhe teknik me institucionet e Brukselit. PSBE i jep këshilla dhe mbështetje Qeverisë së Kosovës lidhur me proceset politike; ofron bashkërendim të përgjithshëm për pranitë e BE-së në Kosovë; dhe kontribuon në zhvillimin dhe në konsolidimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive thelbësore në Kosovë. PSBE i raporton Këshillit të Bashkimit Evropian, trupit ndërqeveritar i cili i përfaqëson të 28 shtetet anëtare të BE-së, përmes Përfaqësueses së Lartë/Zëvendësueses së presidentit të Komisionit Evropian, Federica Mogherini.

EULEX

Baza ligjore për funksionimin e këtij Misioni është përcaktuar nga Këshilli me anë të Veprimit të përbashkët të Bashkimit Evropian 2008/124/CFSP më 4 shkurt 2008. Në bazë të kësaj, EULEX-i funksionon në kuadër të kornizës së përgjithshme të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. EULEX Kosova është krijuar me synimin e përgjithshëm që t'i ndihmojë institucionet, organet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit të Kosovës në zhvillimin e drejtësisë efektive të bazuar në sundimin e ligjit dhe të lirë nga ndikimet politike. Ky Mision është misioni më i madh civil i themeluar në kuadër të Politikave të Përbashkëta për Siguri dhe Mbrojtje (CSDP) të bashkimit Evropian. Pas funksionalizimit të EULEX-it në dhjetor 2008, detyra e tij e parë ishte shqyrtimi i anëve të forta dhe të dobëta në kuadër të fushës së sundimit të ligjit. Gjatë dy viteve të para të mandatit të EULEX-it (2008-2010), ky Mision i ka përkrahur institucionet kosovare duke e monitoruar, mentoruar dhe këshilluar secilin komponentë të sundimit të ligjit (d.m.th. Drejtësinë, Policinë dhe Doganën). Përmes këtyre aktiviteteve, EULEX-i i ka ndihmuar institucionet, organet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit të Kosovës në avancimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies dhe në zhvillimin dhe fuqizimin e mëtejshëm të sistemit të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor shumë-etnik e të pavarur.

¹Përshkrimi i Zyrës së BE-së në Kosovë dhe EULEX-it është marrë nga faqet zyrtare të tyre dhe si i tillë është identik: [1.http://www.eulex-kosovo.eu/?page=1.44](http://www.eulex-kosovo.eu/?page=1.44)

EULEX-i kishte edhe kompetenca ekzekutive në fushën e sundimit të ligjit, në veçanti sa i përket hetimit dhe ndjekjes penale të krimeve të rënda dhe të ndjeshme. Në pajtim me Ligji Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, rastet janë hetuar dhe sjellë para gjykatës nga prokurorët e EULEX-it kurse janë gjykuar nga trupat gjykues me shumicë të gjyqtarëve ndërkombëtarë (sipas ligjeve të Kosovës trupi gjykues përbëhet nga tre gjyqtarë). Përveç kësaj, me anë të monitorimit, mentorimit dhe këshillimit (MMK), EULEX-i i ka përkrahur homologët e tyre në sistemin gjyqësorë të Kosovës me anë të masave për ndërtim të kapaciteteve. Fuqizimi i pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe krijimi i procedurave gjyqësore dhe prokuroriale në përputhje me standardet ndërkombëtare ishte pjesa kryesore e mandatit të EULEX-it.

Në qershor 2010, ky Mision në Kosovë u vazhdua për një periudhë prej dy vitesh. Objektivat kryesore të tij mbetën të njëjta. Vazhdimi I mandatit të EULEX-it në vitin 2012 u shoqërua me një reduktim të konsiderueshëm të personelit dhe ristrukturim të Misionit. Ky Mision u rikonfigurua me dy sektorë kryesorë: “Sektori Ekzekutiv”, I cili punoi në mandatin ekzekutiv të misionit dhe “Sektori për Fuqizim”, I cili përqëndrohet në monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e homologëve vendas.

Vazhdimi i fundit i mandatit të këtij Misioni në qershor 2014 ka sjellë ndryshime të mëdha. Në pajtim me Ligji Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë i ndryshuar me anë të Ligji Nr. 04/L-273 (tani quhet: Ligji mbi juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë), përbërja e trupave gjykues do të jetë me shumicë të kosovarëve dhe pakicë të ndërkombëtareve. Ky Mision nuk do të merr përsipër raste të reja dhe gradualisht do t'ia bart kompetencat sistemit gjyqësor të Kosovës. Përgjatim për këtë është veriu i Kosovës, ku EULEX-i do të vazhdojë të jetë përgjegjës për procedurat gjyqësore derisa Dialogu i lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit të mos sjellë ndonjë zgjidhje për drejtësinë.

Marrëveshja e muajit qershor 2014 mbështetet në shkëmbimin e letrave ndërmjet Presidentes Atifete Jahjaga dhe Përfaqësueses së lartë të BE Catherine Ashton më 14 prill 2014. Pas kësaj u modifikua mandati aktual I EULEX-it dhe për pasojë është reduktuar edhe më tej numri I personelit të tij. EULEX-i e ka ruajtur strukturën themelore të tij, d.m.th. dy sektorët kryesorë “Ekzekutiv: dhe “Fuqizim”. Këtij Misioni i është ngarkuar edhe detyra për të ndihmuar në zbatimin e marrëveshjes të arritura në kuadër të dialogut Beograd - Prishtinë dhe të inkorporuara në “Marrëveshjen e parë ndërkombëtare mbi parimet për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sërbisë të nënshkruar më 19 prill 2013. Mandati aktual I EULEX-it skadon me 14 qershor 2018

EULEX-i e zbaton mandatin e tij përmes dy objektivave:

Përmes objektivit të tij të "Monitorimit, Mentorimit dhe Këshillimit", ky Mision do të përqendrohet në ofrimin e mbështetjes për institucionet kosovare të sundimit të ligjit në nivelet e shtabeve dhe të drejtuesve të lartë të institucioneve përkatëse të Sundimit të Ligjit për ta përforcuar rrethin e drejtësisë penale, me theks në luftimin e ndërhyrjes politike dhe monitorimin e lëndëve të ndjeshme. Në bashkëpunim të ngushtë me PSBE në Kosovë, ai do të ofrojë mbështetje në dialogun Beograd-Prishtinë për të ndihmuar me zbatimin e marrëveshjeve të mbetura të dialogut në sferën e sundimit të ligjit.

Përmes objektivit të tij "Ekzekutiv", EULEX-i do të sigurojë që të ofrohen shërbimet ligjore deri atëherë kur progresi i autoriteteve vendase të lejojë kalimin e plotë të funksioneve ekzekutive tek autoritetet vendase. Ky Mision do t'i mbështesë gjykimet në lëndët e të drejtës kushtetuese dhe civile, si dhe ndjekjen dhe gjykimin e lëndëve të përzgjedhura penale. Në të njëjtën kohë, lëndët e EULEX-it do të vlerësohen vazhdimisht me qëllim që këto lëndë të rikualifikohen si lëndë të përbashkëta, duke i angazhuar më tej autoritetet kosovare të drejtësisë, prokurorisë dhe ato hetimore në mënyrë që të ndërtohen kapacitetet kosovare në këto fusha. Të gjitha lëndët për të cilat EULEX-i nuk e ka më juridiksionin prej datës 15 prill 2014 do të trajtohen nga Kosova. Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it do të vazhdojnë të jenë të bashkëvendosur në institucionet e Kosovës dhe të shërbejnë në përputhje me ligjet kosovare.

Shtojca 3: Fjalorth²

Bashkë-vendimmarrje:	Termi i përdorur më parë për atë që tani është procedura e zakonshme legjislativë.
Bikamerale:	trup legjislativ/Parlament i ndarë në dy dhoma
COREPER:	Një komitet i Këshillit i përbërë nga përfaqësuesit e përhershëm të shteteve anëtare , e cila përgatit punën e Këshillit. COREPER I përfshin zëvendës ambasadorët dhe COREPER II përbëhet nga ambasadorë.
Deklarata me shkrim:	Një deklaratë me shkrim është një tekst me një maksimum prej 200 fjalësh mbi një çështje që bie në sferën e veprimtarisë së Bashkimit Evropian, të paraqitur deri në pesë Deputetët. Nëse nënshkruhet nga shumica e deputetëve, ajo i përcillet institucionit në të cilin është adresuar. Deputetët mund të përdorin deklaratat me shkrim për të nisur ose rifilluar një debat për çështjen që vjen brenda mandatit të BE-së. Kartela tjetër Kur Komisioni paraqet një propozim të ri legjislativ, ajo i dërgohet parlamenteve kombëtare. Nëse një e treta e tyre mendojnë se projektligji nuk është në përputhje me parimin e subsidiaritetit, Komisioni duhet të rishikojë propozimin dhe të vendosë nëse do ta mbajë, ndryshojë ose tërheqë atë dhe të justifikojë vendimin e tij.
Evropianizmi:	transformimi i vlerave evropiane tek një shtet kandidat
Europesimizmi:	kontestimi i funksionimit të Bashkimit Evropian
Intergovernmentale/ Ndërqeveritare:	Institucione ndërqeveritare: të themeluara me përfaqësuesit e deleguar nga shtetet anëtare

²Definimi i fjalëve është marrë dhe përshtatur nga:

<https://quizlet.com/36717927/european-union-vocabulary-flash-cards/>

<http://en.euabc.com/>

http://www.ejtn.eu/Documents/Resources/Handbook_Linguistics_Civil_2013_EN_FR.pdf

- Gazeta Zyrtare:** Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian (OJ) përmban legjislacionin e BE-së, informacionin, njoftimet dhe punën legjislative paraprake. Është botuar çdo ditë pune në të gjitha e gjuhëve zyrtare të BE-së. Vetëm aktet ligjore të publikuara në OJ janë të detyrueshme.
- Gjuha Zyrtare:** Ekzistojnë 24 gjuhë zyrtare të BE-së: bullgarisht, kroatisht, çekisht, danisht, holandisht, anglisht, estonisht, finlandisht, frëngjisht, gjermanisht, greqisht, hungarisht, irlandisht, Letoneze, Lituaneze, Malteze, Polake, Portugeze, Rumune, Sllovake, Sllovene, Spanjolle dhe Suedeze. I gjithë ligji i BE-së publikohet në të gjitha gjuhët zyrtare.
- Grupi Politik:** Deputetët evropianë organizohen jo nga kombësia, por nga përkatësia politike. Aktualisht janë 7 grupe politike në Parlamentin Evropian. Anëtarët mund t'i përkasin vetëm një grup politik. Disa deputetë nuk i përkasin një grupi politik dhe njihen si anëtarë të paangazhuar.
- Kryetar i Parlamentit Evropian:** Presidenti i Parlamentit Evropian kryeson seancat plenare, Konferencën e Presidentëve dhe Byronë (e përbërë nga nënkryetarët e PE). Ai përfaqëson Parlamentin brenda BE-së dhe ndërkombëtarisht.
- Konsultimi publik:** Në konsultimet publike Komisioni Evropian kërkon nga palët e ndryshme të interesit, si autoritetet publike, autoritetet e shteteve anëtare, ndërmarrjet, (private) organizatave, shoqatave të industrisë, qytetarëve, për të paraqitur pikëpamjet e tyre mbi legjislacionin e synuar. Zakonisht merr formën e një pyetësoi me të hapur dhe të mbyllur pyetje.
- Kolegji i Komisionerëve:** Kolegji përbëhet nga 28 komisionerë evropianë përfaqësues

Komisioni në Parlamentin Evropian:	20 komisione të përhershme të Parlamentit hartojnë, ndryshojnë dhe miratojnë propozime legislative, të cilat pastaj votohen nga PE si tërësi gjatë seancave plenare. PE mund të krijojë nënkomisione, komisione të posaçme të përkohshme dhe komitete formale të hetim.
Komiteti i Rajoneve:	Komiteti i Rajoneve është një organ konsultativ i BE-së me 353 anëtarë, që përfaqëson autoritetet lokale dhe rajonale. Duhet të konsultohet gjatë vendimmarrjes në BE në fushat e: kohezionit ekonomik dhe social, rrjeteve infrastrukturore trans-evropiane, shëndetësisë, arsimit dhe kulturës, politikës së punësimit, politikës sociale, mjedisit, trajnimit profesional dhe transportit.
Komisioni i pajtimit:	Komiteti i Pajtimit mblidhet gjatë fazës së pajtimit të procedurës së zakonshme legislative. Ai përbëhet nga numri i njëjtë i shtetit anëtar përfaqësues dhe deputetëve (aktualisht 28/28). Komisioni është përgjegjës për hartimin e një teksti të përbashkët, i cili i vihet Këshillit dhe Parlamentit për miratim në leximi i tretë.
Letër e bardhë:	Dokumentet e bardha të Komisionit janë dokumente që përmbajnë propozime për veprim të BE-së në një fushë të caktuar. Në disa raste ata ndjekin një Libër të Gjelbër të botuar për të filluar një proces konsultimi në nivel evropian. Kur një Letër e Bardhë pranohet mirë nga Këshilli, ajo mund të çojë në një program veprimi për Bashkimin në këtë zone në fjalë.
Nisma qytetare:	Iniciativa qytetare lejon 1 milion qytetarë nga të paktën një e katërta e shteteve anëtare të BE, të kërkojnë nga Komisioni Evropian të dalin me propozime për ligje të reja në fushat në të cilat ka kompetencë.
Opinion (i një komiteti):	Komisioni parlamentar përgjegjës për një çështje mund të kërkojë komisione të tjera për mendimin e tyre. Kryetari dhe raportuesi i komisionit që jep një mendim janë: shpesh të ftuar për të marrë pjesë në mbledhjet e komisionit përgjegjës. Mendimi është shpesh në formën e një raporti të shkruar.

Procedura e pajtimit:	Pajtimi është faza e tretë dhe e fundit e procedurës së zakonshme. Ajo zhvillohet kur Parlamenti dhe Këshilli nuk arrijnë të arrijnë marrëveshje për një legjislativ gjatë dy leximeve të para. Delegacionet nga Këshilli dhe Parlamenti kërkojnë një kompromis të pranueshëm për të dyja.
Pyetje parlamentare:	Pyetjet parlamentare janë adresuar nga deputetët në institucionet dhe organet e tjera të BE-së. Marrësi duhet të japë një përgjigje brenda një afati të caktuar kohor. Pyetjet parlamentare janë një formë e drejtpërdrejtë e shqyrtimit parlamentar mbi institucionet dhe organet e tjera të BE.
Peticione në Parlamentin Evropian:	Çdo qytetar, rezident ose kompani, organizatë ose shoqatë e BE-së me selinë e saj në BE, mund të kërkojë nga Parlamenti çdo subjekt që bie nën dhe që i prek ata drejtpërdrejt. Këto peticione i japin Parlamentit Evropian mundësinë për të tërhequr vëmendjen tek çdo shkelje e një qytetari evropian të drejtat nga një shtet anëtar , autoritet lokal ose institucion tjetër.
Proporcionaliteti:	Sipas parimit të proporcionalitetit, përfshirja e institucioneve të BE duhet të kufizohet në atë që është e nevojshme për të arritur objektivat e Traktateve.
Raport:	Kur një propozim i Komisionit i përcillet një komisioni parlamentar, komiteti emëron një raportues për të përgatitur një raport, i cili zakonisht përbëhet nga ndryshimet në propozim, justifikimet e shkurtra dhe një deklaratë shpjeguese, duke përfshirë një deklaratë financiare që vlerëson ndikimin financiar të propozimit dhe pajtueshmërinë e saj me buxhetin afatgjatë
Raportuesi ,Shadow':	Raportuesi i hijes është një deputet i Parlamentit Evropian i cili vëzhgon një dosje ose raport të PE në emër të një grupi politik përveç atij të raportuesit.
Raportuesi:	Një deputet, i emëruar nga komisioni parlamentar përgjegjës për trajtimin e një propozimi legjislativ, i cili do ta drejtojë propozimin përmes PE dhe do të përgatisë një raportoni mbi të.

- Ratifikimi:** Votimi i një dokumenti të rëndësishëm të nga shtetet anëtare, e cila si procedurë dallon nëpër shtete. Disa shtete aplikojnë ratifikimin e Traktateve në parlament dhe disa të tjera e bëjnë drejtpërdrejtë nga populli-me referendum.
- Referendum:** Një votim i përgjithshëm nga ana e elektoratit për një çështje të vetme politike që u është referuar atyre për një vendim të drejtpërdrejtë.
- Subsidiaritetit:** Sipas parimit të subsidiaritetit, BE-ja nuk duhet të veprojë (përveç në fushat që bien në kompetencën e saj ekskluzive), përveç nëse veprimi i BE-së është më efektiv se veprimet e ndërmarrja në nivel kombëtar, rajonal ose lokal. Janë bërë kontrole të vazhdueshme për të verifikuar se veprimi në nivel të BE është i justifikuar.
- Supranacionale:** mbikomhtar, mbiqeveritar
Institucione të themeluara me qëllim të marrjes së vendimeve në nivel më të lartë se shteti
- Seancat plenare të Parlamentit:** zhvillohen 12 herë në vit në Strasburg, me plenare më të shkurtra në Bruksel. Plenari sjell së bashku të gjithë 751 deputetët për debat dhe votojnë mbi legjislacionin e BE-së dhe miratojnë një qëndrim mbi çështjet politike.
- Shumica e kualifikuar (në Këshillin e Ministrave):** Shumica e kualifikuar përfshin votimin për nga të paktën 14 shtete që përfshiejnë të paktën 62% të popullsisë së përgjithshme të Bashkimit Evropian. Që nga 1 janari 2007, ndarja për numrin e votave që i atribuohet secilit Shtet anëtar është si vijon: pragu për një shumicë të kualifikuar është vendosur në 255 vota nga 345 (73.91%). Vendimi gjithashtu kërkon një votim të favorshëm nga shumica e shteteve anëtare (dmth. së paku 14 shtete anëtare). Në valët e njëpasnjëshme të reformës institucionale, votimi i shumicës së kualifikuar ka zëvendësuar unanimitetin, që është më pak efektiv për zhvillimin e një politike operacionale të BE-së (rreziku i vetos). Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, regjimi i lartpërmendur do të vazhdojë deri më 31 tetor 2014 (shih Neni 16 (4) TEU, neni 238 TFEU dhe Protokollin nr. 36 mbi Dispozitat Kalimtare).

Shumica e thjeshtë (në Parlamentin European):

Shumica e anëtarëve që marrin pjesë në votim. Sipas procedurës së bashkë-vendim-marrjes, kërkohet një shumicë e thjeshtë kur votojnë në komisionin parlamentar, në seancë plenare në leximin e parë dhe në leximin e dytë, miratojnë qëndrimin e Këshillit në leximin e parë dhe me qëllim të hartimit të aktit në përputhje me drafti i përbashkët i përgatitur nga Komiteti i Pajtimit.

Shumica absolute (në Parlamentin European):

Një shumicë absolute përbën shumicën e të gjithë anëtarëve të Parlamentit Evropian (duke përfshirë edhe ata që mungojnë ose nuk votojnë). Në konfigurimin e tij të sotëm me 751 deputetë, pragu për një shumicë absolute është 376 vota.

Shumica e kualifikuar në Këshill:

Një shumicë e cilësuar në Këshill përfshien të paktën 55% të anëtarëve të Këshillit (shtetet anëtare), duke përfshirë një minimum prej 16 vendeve, që përfaqësojnë së paku 65% e popullsisë së BE. Një pakicë bllokimi mund të formohet nga të paktën katër anëtarë të Këshillit.

Traktatet:

Një traktat është një marrëveshje e detyrueshme midis vendeve anëtare të BE. Ajo përcakton objektivat e BE-së, rregullat për institucionet e BE-së, si merren vendimet dhe marrëdhënia midis BE-së dhe vendeve të saj anëtare.

Unanimitet (në Këshill)

Unanimiteti kërkon që të gjitha shtetet anëtare që takohen brenda Këshillit të bien dakord mbi një propozim para se të mund të miratohet. Që nga Traktati i Lisbonës vetëm një numër i kufizuar i politikave të gjykuara si të ndjeshme mbeten subjekt i votimit me unanimitet.

Literatura dhe burimet

Institucionet e BE-së:

<http://www.europarl.europa.eu/portal/en>

https://ec.europa.eu/commission/index_en

<http://www.consilium.europa.eu/en/european-council/>

http://europa.eu/european-union/about-eu/institutions-bodies/court-justice_en

<http://www.eca.europa.eu/en/Pages/ecadefault.aspx>

<https://www.ecb.europa.eu/home/html/index.en.html>

<http://www.consilium.europa.eu/en/council-eu/preparatory-bodies/coreper-i/>

https://curia.europa.eu/jcms/jcms/Jo2_6999/en/

Vendimmarrja në BE:

https://europa.eu/european-union/eu-law/decision-making/procedures_en

Për BE-në:

https://europa.eu/european-union/index_en

Për BE-në në Kosovë:

https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo_en

<http://www.eulex-kosovo.eu/>

Zgjerimi i BE-së:

http://www.euic.mk/content/Brochures-NEË/ALB/11.Enlargement_AL/files/basic-html/page8.html

Themeluesit e BE-së:

https://europa.eu/european-union/about-eu/history/founding-fathers_en

Të tjera:

http://ec.europa.eu/regional_policy/en/

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-069%20sh.pdf>

<http://www.mei-ks.net/en/kosovo-eu-relations>

<http://www.mfa-ks.net/>

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-069%20sh.pdf>

http://ec.europa.eu/regional_policy/en/funding/ipa/

<http://www.eubusiness.com/neës-eu/politics-treaty.19r/>

<http://eur-lex.europa.eu/homepage.html>

http://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/instruments/funding-by-country/kosovo_en

http://europa.eu/european-union/about-eu/funding-grants_en

http://www.mei-ks.net/repository/docs/15_Pyetje_per_Bashkimin_Evropian.pdf

http://www.euic.mk/content/Brochures-pdf-NEW/ALB/11.Enlargement_AL.pdf

Libra:

Halter, Ulrich, Europarecht - Dogmatik im Kontext, Mohr Siebeck UBT, Tübingen, 2005

Holzinger/Kill, Peter/Rittberger, Schimmelfening, Wagner: Europäische Union, Ferdinand Schoeningh UBT, Paderborn, 2005

Jacque, Jean Paul: E drejta institucionale e Bashkimit Evropian, Papirus, 2010
Lazowski, Adam, Aida Gugu Bushati, Bazat e se drejtës Europiane, Guttenberg, Tiranë, 2014

Reka, Blerim dhe Ylber Sela: Hyrje në të drejtën e Unionit Evropian. Universiteti i Evropës Jug Lindore, Tetovë, 2011

Teasdale, Anthony and Bainbridge Timothy, The Penguin Companion to European Union, 2014

Seibt, Ferdinand: Die Begründung Europas, Bundeszentrale fuer politische Bildung, Bonn, 2005

Weidenfeld, Werner: Die Europäische Union, Wilhelm Fink, Paderborn, 2015



Jehona Lushaku Sadriu aktualisht është profesore në Departamentin e Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës dhe kordinatore në programin Erasmus+ në Kosovë. Ajo ka mbaruar studimet e doktoratës në Universitetin e Hanoverit me temë: Evropianizimi përmes kushtëzimit dhe deliberimit në vitin 2019. Studimet master i ka përfunduar në Gjermani, në Universitetin e Hanoverit, drejtimin MA

Integrime Evropiane- Jeann Monnet, kurse paraprakisht ka përfunduar dy fakultete në Universitetin e Prishtinës: në drejtimin e Shkencave Politike dhe Administratës Publike si dhe në Gjuhë dhe Letërsi Gjermane.

Për sukses në studime dhe angazhim social, ajo është zgjedhur studente e vitit 2005 në Universitetin e Hanoverit, me ç'rast i është ndarë cmimi Victor-Reizkallah. Gjatë studimeve ka qenë bursiste e Konrad Adenauer Stiftung dhe ka përfunduar praktika profesionale në Parlamentin Evropian, Bundestag, Parlamentin e Landit të Saksonisë së Ulte dhe DW në Berlin.

Ajo aktualisht është profesoreshë në Departamentin e Shkencave Politike në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 2013, ajo ka qëndruar një semestër në Universitetin e Salzburgut në Austri si ligjeruese mysafire në Qendrën e Studimeve Evropiane. Në mes të viteve 2010-2014 ajo ka ligjeruar në disa programeve ndërkombëtare akademike: Summer University South East Europe-2007-Uni Vienna, Sommerakademie des GSI- Bonn 2014, 2015; Universiteti

Ndërkombëtar Veror i Prishtinës 2011, 2015; EU Law Winter School 2010-UP, Akademisë evropiane për të rinj 2016, 2017; etj. Ka marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare akademike në Stamboll, Vjenë, Berlin, Hanover, Mynhen, York, etj.

Ajo është autore e disa punimeve akademike me te indeksuara ndërkombëtarisht (EBSCO) dhe i dy librave” në gjuhë angleze: Lushaku Sadriu, Jehona.(2019) Europeanization through Conditionality and Deliberation in the EU Enlargement Process: An analysis of the case study of Kosovo. LIT Verlag, Berlin, Germany

<https://www.lit-verlag.de/publikationen/politikwissenschaft/73307/europeanization-through-conditionality-and-deliberation-in-the-eu-enlargement-process>

dhe nje libri ne shqip:

Lushaku Sadriu, Jehona (2017) Bashkimi Evropian- nje permbledhje e shkurter, Konrad Adenauer Stiftung, Prishtine, Kosovë.

Përveq karrierës akademike, Lushaku Sadriu angazhohet në ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë në Kosovë përmes projekteve evropiane. Ajo udhëheqë Zyrën Erasmus+ dhe angazhohet që Kosova të rrisë projektet ndërkombëtare për shkëmbim të studentëve, përfitim të projekteve në ndërtim të kapaciteteve, etj. Nga viti 2019 kurse gjatë viteve 2007-2010 ka qenë Drejtoreshë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Universitetin e Prishtinës, e më pas ka menaxhuar për dy vite projektin austriak KAIP për arsimin e lartë në Kosovë. Ajo për kohë të caktuara është angazhuar nga UNDP si Këshilltare për Integritet Evropiane në zyrën e Kryeministrit të Kosovës dhe në Ministrinë e Drejtësisë. Fushat e saj të ekspertizës janë: integritet evropiane dhe arsimit i lartë.



ISBN 978-9951-8664-1-5

